	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 1 prej 46</i>

Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës

Qershor 2023



	MODELI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 2 prej 46</i>

TABELA E PËRMBAJTJES

PËRMBLEDHJE.....	3
1 HYRJE.....	5
1.1 Qëllimi i këtij dokumenti	5
1.2 Fushëveprimi i këtij dokumenti.....	5
1.3 Parimet dhe politikat.....	6
1.4 Obligimet dhe objektivat e KOSTT-it	9
2 VËSHTRIM I PËRGJITHSHËM I MODELIT TË TREGUT	11
2.1 Struktura aktuale: palët dhe përgjegjësitë.....	11
2.2 Masat e mundshme për të lehtësuar konkurrencën.....	15
3 MODELI I SYNUAR	17
4 OPERIMI I TREGUT	18
4.1 Parimet e operimit të tregut	18
4.2 Operimi i tregut	24
4.3 Promovimi i burimeve të ripërtëritshme	31
5 RREGULLAT E TREGUT – ZBATIMI I MODELIT TË TREGUT	33
5.1 Hyrje	33
5.2 Pjesa I: Dispozitat e përgjithshme	33
5.3 Pjesa II: Operimi i Sistemit.....	35
5.4 Pjesa III: Barazimi përfundimtar	37
5.5 Pjesa IV: Administrimi.....	39

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 3 prej 46</i>

Përmbledhje

Sipas Ligjit për Energjinë Elektrike, Operatori i Tregut (OT) përgatitë Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës dhe çdo modifikim të tij, në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës. Modeli është i kufizuar në atë që KOSTT-i mund të arrijë në tregjet e energjisë dhe kapaciteteve dhe nuk mund të ndikojë drejtpërdrejt në investimet në kapacitete të reja, të cilat kërkojnë iniciativa të Qeverisë.

Pjesët që mund të përfshihen në modelin e tregut pjesërisht janë paraqitur si në vijim:

1. Përmirësimi i qëndrueshmërisë së sistemit

- Modeli lejon integrimin e SBRE (Sistemi i Baterisë për Ruajtjen e Energjisë) për të ofruar shërbime ndihmëse të përmirësuara, të prokuruar në mënyrë efikase nëpërmjet kontratave të shërbimeve ndihmëse, duke përfshirë edhe prokurimin jashtë kufijve.
- Sinjalet efikase të çmimeve për mungesën e kapaciteteve të ndërtuara në një model tregu të përshtatur ngushtë rreth Modelit të Synuar të BE-së duke përdorur vlerën e ngarkesës së humbur për të vlerësuar sigurinë e furnizimit, e cila do të nxisë investime të reja.

2. Mbështetja e dekarbonizimit dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme

- Modeli lejon integrimin e kontratave të reja dhe të ndryshme të energjisë së ripërtëritshme me forma të ndryshme mbështetjeje me rregulla të ndryshme të atribuimit të kostos së balancimit.
- Modeli përfshinë platforma të reja tregtare (ALPEX PX) për nxitjen e burimeve të ripërtëritshme në treg me kosto të ulët.

3. Fuqizimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimi i tregut


- KOSTT është njohur si OST në kuadër të ENTSO-E me zonën e vet rregulluese në një bllok rregullues me Shqipërinë. Kjo përmirëson funksionimin e sistemit të transmetimit dhe të tregut duke përfshirë pjesëmarrjen në barazimin përfundimtar financiar për shkëmbimet e paqëllimshme.
- KOSTT merr pjesë në iniciativa pan-evropiane si alokimi i DTF-ve nga SEE CAO dhe në zhvillimin e bashkimit të tregut me Shqipërinë.
- Proceset e nominimit përdorin forma dhe procedura të standardizuara të ENTSO-E.
- Kosova synon të zbatoj Modelin e Synuar të BE-së në përputhje me zotimet e Traktatit të Komunitetit të Energjisë.

4. Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve

- Zhvillimi i tregut funksional dhe konkurrues me shumicë është thelbësor për mbrojtjen e konsumatorit.

Modeli i Tregut ka këto karakteristika:

- **Tregjet konkurruese**
- **Çmimet transparente dhe kosto reflektive të tregut**

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 4 prej 46</i>


- **Nuk ka ndër-subvencionim¹**
- **Sistem të sigurt ku konsumatorët mbështesin investimet e nevojshme nëpërmjet tarifave të tyre**
- **Përmirësim i mjedisit.**

Modeli i Synuar i BE-së është kyç për Modelin e Tregut. Ky model bazohet në tregje të organizuara në periudha të ndryshme kohore si më poshtë:

- **Tregjet e ardhshme:**
 - Kontratat dypalëshe për periudhën e ardhshme.
 - Kontratat e shërbimeve ndihmëse mund të prokurohen duke përfshirë pagesën e disponueshmërisë së kapacitetit si dhe pagesën e shfrytëzimit të energjisë.
 - Të drejtat afatgjata të transmetimit fizik (DTF) të alokuara nga SEE CAO në emër të KOSTT-it në shumicën e kufijve.
- **Tregjet një ditë para:**
 - Nominimet e rrjedhave të energjisë kundrejt DTF-ve dhe DTF-ve të papërdorura të konvertuara në të drejta të transmetimit financiar për përdorim në bashkimin e tregut ose të shitura si DTF-të e ditës në vijim ku nuk ka bashkim tregu.
 - Ankand i organizuar nga ALPEX një ditë përpara si pikëprerje e lakoreve të urdhërporosive të blerjes dhe shitjes duke përfshirë bashkimin e tregjeve aty ku është e mundur.
- **Tregjet brenda ditës:**
 - ALPEX do të organizojë gjithashtu edhe tregtimin e ashtuquajtur brenda ditës si pikëprerje e urdhërporosive të blerjes dhe shitjes në afatet brenda ditore.
 - SEE CAO do të nxjerrë në ankand kapacitetin ditor për përdorim në tregtitë ndërkufitare (në kufijtë që nuk mbështesin tashmë bashkimin e tregut).
- **Tregu balancues:**
 - KOSTT si OST do të pranojë oferta për blerje dhe shitje për balancimin në kohë reale të sistemit bazuar në parashikimet e jobalancit të sistemit.
 - KOSTT do të përdorë kontratat e shërbimeve ndihmëse për të reaguar ndaj ndryshimeve në kohë reale të shkëmbimit dhe të frekuencës.

Siç specifikohet në Ligjin për Energjinë Elektrike, Modeli i Tregut është bazë për një sërë rregullash që ofrojnë një operim gjithëpërfshirës të balancimit dhe barazimit përfundimtar në përputhje me Modelin e Tregut.

¹Modeli i Tregut siguron kosto reflektive për koston e shërbimeve të transmetimit dhe shërbimeve me shumicë, por nuk mund të zbatohet në vetvete ndonjë politikë të eliminimit të ndërsuvencionimit, megjithatë nuk e pengon këtë politikë.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 5 prej 46</i>

1 Hyrje

1.1 Qëllimi i këtij dokumenti

Në përputhje me nenin 23.6 të Ligjit Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, Operatori i Tregut do të përgatisë Modelin e Tregut të Energjisë Elektrike dhe çdo ndryshim të tij, në përputhje me Strategjinë e Energjisë të Republikës së Kosovës.

Kosova ka zbatuar një treg kontratash dypalëshe me përgjegjësi balancimi në përputhje me parimet e Modelit të Synuar të BE-së të themeluar nga Pakoja e Tretë e Energjisë e BE-së; Kosova është e përkushtuar për këtë si Palë Kontraktuese e Traktatit të Komunitetit të Energjisë (TKE) me BE-në. Procesi i TKE-së përfshin Palët Kontraktuese që bien dakord të miratojnë elementet e Acquis Communautaire të BE-së në sferën e energjisë për të siguruar miratimin (transponimin) efikas të Direktivave të miratuara të BE-së, në mënyrë që të jetë në përputhje me parimet e Direktivës, por me përshtatjet e nevojshme për të përmbushur kufizimet e miratimit në vendet jashtë BE-së. Në qendër të këtij angazhimi është lëvizja drejt zbatimit të të ashtuquajturave “kodet e rrjetit” nga modeli i synuar, duke përfshirë:

- Udhëzuesin për Alokimin e Kapaciteteve dhe Menaxhimin e Kongjestionit (CACM);
- Udhëzuesin për Alokimin e Kapaciteteve të Ardhshme (FCA); dhe
- Udhëzuesin për Balancimin e Energjisë (EBGL).

Të rëndësishme gjithashtu janë:

- Direktiva e Energjisë së Ripërtëritshme; dhe
- Rregullorja e propozuar e BE-së për gatishmërinë ndaj rrezikut në sektorin e energjisë elektrike dhe iniciativat e saj për koordinimin rajonal të sigurisë në të cilën merr pjesë Kosova.


Ky dokument është një rishikim dhe përditësim i dokumentit të mëparshëm të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të miratuar dhe publikuar në mars 2013 siç kërkohej nga ligjet e mëparshme mbi të cilin ndërton dhe përcakton objektivat e politikave për pesë vitet e ardhshme.

1.2 Fushëveprimi i këtij dokumenti

Ky dokument mbulon:

- Parimet dhe politikat e Qeverisë
- Detyrimet dhe objektivat e KOSTT-it
- Veprimet e KOSTT-it në kuadër të tregut
- Mënyrën e organizimit të tregut
- Mënyrën e funksionimit të balancimit dhe barazimit përfundimtar
- Detyrime të tjera që rrjedhin nga tregu dhe strategjia.

Në Shtojcë është fjalori i shkurtesave dhe termave të referuara në këtë dokument.

	MODELI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 6 prej 46</i>

1.3 Parimet dhe politikat

1.3.1 Strategjia e Qeverisë për energjinë

Modeli i Tregut duhet të jetë në përputhje me Strategjinë e Energjisë të aprovuar nga Qeveria. Strategjia e Energjisë ka përcaktuar disa objektiva strategjike:

1. Përmirësimi i qëndrueshmërisë së sistemit me:

- a. Rritjen e fleksibilitetit të sistemit;
- b. Modernizimin e rrjetit dhe zvogëlimin e humbjeve në rrjet;
- c. Revitalizimin e kapaciteteve ekzistuese për prodhimin e energjisë elektrike dhe investimet në kapacitete të reja; dhe
- d. Përmirësimet në sigurinë kibernetike në sektorin e energjisë.

Këtu përfshihet edhe synimi për: përmirësimin e treguesve të cilësisë së furnizimit (Indeksi Mesatar i Kohëzgjatjes së Ndërprerjes së Sistemit dhe Indeksi Mesatar i Frekuencës së Ndërprerjeve të Sistemit), shërbimet rezervë të bazuara në treg së paku 170 MW si kapacitet fleksibël deri në vitin 2031, vlera maksimale e humbjeve në transmetim dhe shpërndarje deri në 9% deri në vitin 2031 dhe rinovimin e dy njësive në TC Kosova B dhe të paktën një në TC Kosova A deri në vitin 2024.

Modeli i Tregut për tregun me shumicë mund të lehtësojë fleksibilitetin nëpërmjet:


- **Sinjaleve efikase të çmimeve** për korigjimin e jobalancit, shfrytëzimit të shërbimeve ndihmëse dhe instrumenteve të tjera të fleksibilitetit, duke inkurajuar kështu investimet; kjo do të përmirësohet më tej me operacionalizimin e ALPEX për tregun një ditë para dhe brenda ditës.
- **Rregullave fleksibile** që sigurojnë që teknologjitë e reja si SBRE mund të konkurrojnë në ofrimin e fleksibilitetit,
- **Çmimit të ngarkesës së humbur** duke stimuluar zhvillimin adekuat të rrjetit dhe prokurimin e energjisë nga furnizuesit.

Megjithatë, objektivat kryesore do të kërkojnë sigurimin e fondeve të përshtatshme në dispozicion për investime; Modeli i Tregut mund të ndihmojë vetëm që investimi të jetë efikas.

2. Dekarbonizimi dhe promovimi i energjisë së ripërtëritshme me:

- a. Zbatimin gradual të çmimit të karbonit
- b. Promovimin e burimeve të ripërtëritshme
- c. Promovimin e energjisë së ripërtëritshme në ngrohje.

Kjo do të zhvillohet përmes: përgatitjes për integrimin në Sistemin e Tregtimeve të Emetimeve të BE-së deri në vitin 2025, reduktimit të emetimeve të gazeve serrë në sektorin e energjisë me të paktën 32% deri në vitin 2031, prodhimit të BRE-ve që do të arrijë në 35% të konsumit të energjisë elektrike deri në vitin 2031, dhe kapaciteteve të reja prodhuese të erës dhe FV solare që do të arrijnë të paktën 1400 MW deri në vitin 2031, nga të cilat të paktën 100 MW duhet të zhvillohen nga vetëkonsumatorët.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 7 prej 46</i>

Modeli i Tregut mund të lehtësojë burimet e ripërtëritshme me cilësinë duke kombinuar energjinë për ngrohje dhe energjinë elektrike përmes:

- **Sistemeve të barazimit përfundimtar financiar** që njohin rolin qendror të një Operatori të BRE-ve për kombinimin e produkteve nga prodhuesit e energjisë së ripërtëritshme dhe menaxhimin e kostos së jobalanceve të tyre
- **Lehtësimit të tregtisë së burimeve të ripërtëritshme;** që do të përmirësohet kur tregtimi të fillojë në tregun e organizuar në ALPEX.

Në vetvete, Modeli i Tregut nuk mund të sigurojë që investimi do të ndodhë; do të nevojitet gjithashtu skema mbështetëse e parashikuar në legjislacionin e ri për energjinë e ripërtëritshme, e mbështetur nga fondet për këtë mbështetje.

3. **Rritja e efijencës së energjisë** nëpërmjet:
 - a. Përmirësimit të efijencës së ndërtesave
 - b. Bashkëprodhimit dhe ngrohjes qendrore.

Objektivat janë: kufizimi i konsumit final të energjisë në 1877 ktoe deri në vitin 2031, kursimet kumulative të energjisë prej 266,4 ktoe në ndërtesa deri në vitin 2031 dhe ndërtimi i 150 ndërtesave me energji neto afër zeros deri në vitin 2031.

Modeli i tregut nuk luan asnjë rol të drejtpërdrejtë në këtë objektiv.


4. **Forcimi i bashkëpunimit rajonal dhe funksionimit të tregut** nëpërmjet:
 - a. Bashkëpunimit rajonal
 - b. Heqjes së barrierave për funksionimin e tregut
 - c. Trajnimeve në fushat e lidhura me energjinë.

Objektivat janë: integrimi i tregut me Shqipërinë në vitin 2023, bashkimi me zonën e tregut pan-evropian në vitin 2030, heqja graduale e Marrëveshjes së furnizimit me shumicë, duke filluar nga viti 2025 më së voni dhe rritja e numrit të të punësuarve në fushat e lidhura me energjinë ashtu që 25% të punonjësve të sektorit të jenë gra deri në vitin 2031.

Kosova është pjesë e zonës sinkrone të Evropës Kontinentale. Marrëveshja për kyçe e KOSTT-it me ENTSO-E dhe marrëveshja me SEE CAO janë thelbësore për ambiciet integruese të Kosovës. **Rregullat e tregut e lehtësojnë këtë integrim:**

- Zbatimi i **Modelit të Synuar të BE-së** siç kërkohet sipas TKE
- **Alokimi i të drejtave të kapaciteteve ndërkufitare** përmes SEE CAO
- **Rrjedhat ndërkufitare të energjisë dhe bashkimi i tregut** (fillimisht vetëm me Shqipërinë)
- **Balancimi i sistemit.**

5. **Mbrojtja dhe fuqizimi i konsumatorëve me:**
 - a. Mbrojtjen e konsumatorëve në nevojë

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 8 prej 46</i>

- b. Fuqizimin e konsumatorëve
- c. Ruajtjen e mjedisit dhe shëndetit të njeriut.


Objektivat për këtë janë: rishikimi i skemës aktuale të mbështetjes së çmimeve për programin e konsumatorëve të rinj në nevojë deri në vitin 2024, prezantimi i të paktën dy skemave të reja të lidhura me energjinë për konsumatorët në nevojë deri në vitin 2024 dhe zhvillimi i 4 skemave të reja deri në vitin 2031, zhvillimi i më shumë se dy programeve që mbështesin projektet e komunitetit në efikasitet dhe vetëkonsum deri në vitin 2024, dhe më shumë se pesë programe deri në vitin 2031, zbatimi i të paktën nëntë fushatave vetëdijësuese dhe informuese për kursim të energjisë në vit dhe zhvillimi i një mjeti plotësisht funksional të krahasimit të çmimeve deri në vitin 2024.

Modeli i tregut është thelbësor për arritjen e këtij objektivi. Duke zhvilluar një treg funksional dhe konkurrues me shumicë me çmime që reflektojnë koston dhe me një bazë të dhënave të centralizuar të konsumatorëve fundor, mbështetja e synuar mund të projektohet dhe zbatohet ashtu që ndërrimi i furnizuesit të jetë praktik dhe lehtësisht i mundshëm.

1.3.2 Parimet udhëzuese të Modelit të Tregut

Parimet udhëzuese të aplikuara në këtë Model të Tregut, në përputhje me Ligjin për Energjinë Elektrike dhe zotimet e Kosovës sipas TKE-së, janë:


- **Tregjet konkurruese.** Konsumatorët do të shërbehen më mirë nëse ka konkurrencë të lirë në tregjet e prodhimit dhe të shitjes me shumicë, edhe jashtë kufijve përfshirë edhe tregjet me pakicë.
- **Çmimi transparent dhe reflektues i tregut.** Kontratat me shumicë të energjisë duhet të pasqyrojnë çmimet konkurruese të tregut ashtu që të mos ketë ndonjë përparësi asnjë furnizues i energjisë në tregun me pakicë.
- **Ndër-subvencioni.** Konsumatorët me pakicë duhet të paguajnë çmime që reflektojnë koston për energjinë e dorëzuar atyre, duke përfshirë koston e liferimit si dhe koston e vërtetë të energjisë me shumicë. Kur aplikohen tarifa specifike sociale, kostoja nuk duhet të dëmtojë asnjë konsumator tjetër.
- **Përmirësimi i sigurisë së sistemit me konsumatorët që mbështesin investimet e nevojshme nëpërmjet tarifave të tyre.** Aty ku kërkohen përfitime specifike sociale si nga energjia e ripërtëritshme ose siguria e furnizimit, atëherë çdo kosto shtesë duhet të përballohet nga të gjithë konsumatorët në mënyrë proporcionale.
- **Përmirësimi i mjedisit.** Këtu përfshihet prodhimi më i pastër dhe promovimi i energjisë elektrike nga burime të ripërtëritshme.

	MODELI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 9 prej 46</i>

1.4 Obligimet dhe objektivat e KOSTT-it

Obligimet e KOSTT-it si OT janë të përcaktuara në nenin 23 të Ligjit për Energjinë Elektrike, duke kërkuar kryerjen transparente, objektive dhe të pavarur të detyrave që përfshijnë:

- Organizimin e tregut me shumicë të energjisë elektrike në Kosovë në përputhje me rregullat e tregut, të cilat duhet t'i përgatisë për miratim nga Rregullatori dhe të ngarkojë një tarifë të rregulluar për aktivitetet e tij të operimit të tregut.
- Detyrat specifike (siç përcaktohet në ligj):
 - **Menaxhimi ekonomik i sistemit të energjisë elektrike** që përfshin barazimet përfundimtare financiare të jobalanceve dhe faturimin për shërbimet e transmetimit në emër të OST; barazimi përfundimtar financiar i tregtimeve në tregun e organizuar të energjisë elektrike është përgjegjësi e ALPEX, sipas marrëveshjes për transferim të përgjegjësi.
 - **Organizimi dhe zhvillimi i tregut të energjisë elektrike** në dobi dhe avantazh të pjesëmarrësve të tregut të energjisë elektrike. Mënyra se si bëhet organizimi përcaktohet në rregullat e tregut, të cilat përmbajnë gjithashtu rregulla për zhvillimin e nismave të reja për të mbështetur tregun; një shembull i kësaj është bashkëpunimi me OST në barazimin përfundimtar financiar të shkëmbimeve të paqëllimshme me zonat e tjera rregulluese në të gjithë Zonën Sinkrone të Evropës Kontinentale.
 - **Organizimi dhe zhvillimi i tregut të organizuar të energjisë elektrike** në bashkëpunim me Operatorin e Sistemit të Transmetimit. Kjo është shprehur nëpërmjet bashkëpunimit me Shqipërinë në themelimin e ALPEX, e cila ka krijuar kushtet për themelimin e bursës (PX) të Kosovës për t'u bashkuar me tregun e Shqipërisë dhe me plane për t'u bashkuar me tregjet e tjera të energjisë në rajon. Prandaj, dispozitat e Ligjit për ankandet e mundshme për shitjen ose blerjen e energjisë elektrike plotësohen me themelimin e bursës. Në mënyrë të ngjashme, përgjegjësitë për vendosjen e çmimeve të tregut përmbushen nga ALPEX ashtu si dhe njoftimet e rezultateve të tregut.
 - **Regjistrimi i të gjitha transaksioneve të shitblerjes së energjisë elektrike** ndërmjet palëve të tregut të energjisë elektrike. Kjo përdoret për të përcaktuar pozicionin neto të jobalancit të palëve në treg.
 - **Dorëzimi në kohë të Operatori i Sistemit të Transmetimit të programeve ditore të shitjes dhe blerjes së energjisë elektrike.** OT është përgjegjës për mbledhjen e të gjitha nominimeve fizike dhe kontraktuale të të gjitha palëve dhe për njoftimin e tyre tek OST.
 - **Verifikimi i harmonizimit të programeve kontraktuale të tregtimit ndërkufitar, kundrejtë kapaciteteve të alokuara ndërkufitare.** KOSTT është aksionar në SEE CAO, i cili alokon DTF-të ndërkufitare në shumicën e kufijve të Kosovës, si dhe tregtinë dytësore me ato të drejta. SEE CAO gjithashtu pranon nominimet e rrjedhave të energjisë kundrejt atyre DTF-ve. OT-së i jepet një rol këshillues për OST-në për alokimin e kapaciteteve.
 - **Mirëmbajtja e bazës së njehsorëve për të gjithë Furnizuesit.** Siç përcaktohet në rregullat e tregut, OT mirëmban bazën e të dhënave të njehsorëve të konsumatorëve dhe detajet e

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 10 prej 46</i>

nevojshme të tyre në ata njehsorë dhe të furnizuesve të tyre. Kjo përfshin detaje të atyre konsumatorëve të klasifikuar në nevojë.

- **Lidhja e marrëveshjeve të shitblerjes për pjesën e detyrueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe bashkëprodhimi.** OT mund të kryejë detyrën e Operatorit për Energjinë e Ripërtitshme (OER).
- **Mbledhja e pagesave për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe nga bashkëprodhimi,** nga të gjithë furnizuesit, përfshirë furnizuesit me detyrime të shërbimit publik.
- **Analizat e tregut të energjisë elektrike** dhe propozimi i masave për avancimin e tij dhe publikimi i informacionit të nevojshëm për organizimin dhe zhvillimin e papenguar të tregut të energjisë elektrike dhe aktiviteteve të energjisë elektrike.
- **Menaxhimi i procesit të transferimit të konsumatorit,** në përputhje me rregullat e tregut.
- **Instalimi, mirëmbajtja dhe përditësimi i platformës së funksionimit të tregut.** Kjo platformë mund të jetë e auditueshme nga auditor i pavarur
- **Publikimi i të gjitha të dhënave dhe informacioneve të rëndësishme për tregun** dhe detyrimet e tjera që rrjedhin nga rregullat e tregut.

Objektivat e përcaktuara për KOSTT-in janë të përcaktuara në rregullat e tregut. Këto janë:


- (a) përmbushja efikase e detyrimeve të ngarkuara mbi OT nga Licenca e saj;
- (b) lehtësimi i operimit efikas të Rrjetit të Transmisionit nga Operatori i Sistemit të Transmetimit;
- (c) nxitja e konkurrencës efektive në prodhim, tregtim dhe furnizim me energji elektrike;
- (d) zbatimi dhe menaxhimi efikas i balancimit dhe barazimit përfundimtar sipas rregullave të tregut;
- (e) promovimi i përdorimit të burimeve të ripërtëritshme të energjisë në prodhimin e energjisë elektrike.

Këto objektiva përshtaten mirë me objektivat e strategjisë së energjisë. Natyrisht, OT duhet të jetë efikas dhe duhet të lehtësojë OST-në që të operojë në mënyrë efikase. Më gjerësisht, objektivat e lehtësimit të konkurrencës dhe promovimit të energjisë elektrike nga burimet e ripërtëritshme përcaktojnë se si duhet të veprojnë OT për të mbështetur liferimin e energjisë elektrike tek konsumatorët.

1.4.1 Strategjitë kryesore të politikave të KOSTT-it

Obligimet dhe objektivat e KOSTT-it janë paraqitur më lart. Vlen të përmenden këtu strategjitë kryesore që KOSTT do t'i përdorë përmes këtij Modeli të Tregut sepse këto strategji, të cilat janë përmendur tashmë, janë thelbësore për Model. Strategjitë kryesore janë:

- **Bashkëpunimi Evropian:**
 - KOSTT ka nënshkruar Marrëveshje për kyçe me ENTSO-E dhe është i obliguar në skema të ndryshme bashkëpunimi. Kohët e fundit, kjo ka përfshirë një trajtim të ri të shkëmbimit të paqëllimshëm.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 11 prej 46</i>

- KOSTT është aksionar i SEE CAO e platformës së alokimit së koordinuar të kapaciteteve që përdoret për të alokuar të drejtat e kapaciteteve në kufijtë e vetë.
- **Modeli i Synuar i BE-së:**
 - ALPEX PX. Kjo siguron një treg vullnetar të një dite para dhe një treg brenda ditës për Kosovën që do të bashkohet fillimisht me Shqipërinë. KOSTT synon të prokurojë energji për humbjet e transmetimit përmes platformës ALPEX.
 - Rregullat e tregut balancues janë në përputhje me parimet thelbësore të Modelit të Synuar të BE-së.
- **Ligji për Energjinë e Ripërtëritshme:**
 - PX do të ofrojë një çmim referencë për format e reja të kontratës të lejuara sipas ligjit të ri.
 - Rregullat e Tregut do të lejojnë balancimin dhe barazimin përfundimtar të burimeve të reja të ripërtëritshme.
- **Qëndrueshmëria dhe fleksibiliteti i sistemit:**
 - Rregullat e tregut përfshijnë prokurimin e shërbimeve ndihmëse në mënyra të ndryshme nga një shumëllojshmëri burimesh, duke përfshirë edhe pajisjet e ruajtjes (bateritë);


2 Vështrim i përgjithshëm i Modelit të Tregut

2.1 Struktura aktuale: palët dhe përgjegjësitë

Figura 1 paraqet mënyrën aktuale të organizimit të tregut. Mënyra aktuale ndahet në komponentë kyç dhe nxjerr në pah modelin evropian që e ndan tregun thelbësisht në:

- **Tregun fizik** që merret me rrjedhën e energjisë elektrike nga prodhuesit deri te furnizuesit dhe më pas te konsumatorët; dhe
- **Tregun kontraktual** që merret me tregtinë komerciale të energjisë elektrike.

Diagrami është i kufizuar në marrëveshjet për tregtimin dhe liferimin e energjisë elektrike. Mungojnë marrëveshjet për tregtimin e DTF-ve për tregtinë ndër-kufitare. Këto janë të përfshira në përshkrimet e mëposhtme.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 12 prej 46</i>




Figura 1: Organizimi aktual i tregut

Qeverisja

Legjislacioni Evropian. Të gjitha palët qeverisen nga ligjet kryesore të mëposhtme: Ligji për energjinë, Ligji për Rregullatorin e Energjisë dhe Ligji për Energjinë Elektrike. Këto ligje zbatojnë zotimet sipas TKE-së dhe Udhëzimeve të miratuara të Modelit të Synuar të BE-së.


ENTSO-E. Marrëveshja e kyçjes me këtë organ të OST-ve të BE-së është një pjesë e domosdoshme e zbatimit të Modelit të Synuar.

Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE), agjencia e pavarur rregullatore, e cila është përgjegjëse (ndër të tjera) për: licencimin e ndërmarrjeve energjetike, përcaktimin e zbatimeve të Detyrimit të Shërbimit Publik (DSHP) për të licencuar të veçantë për një kohë të kufizuar, rregullimin e çmimeve të monopoleve natyrore, lehtësimin e konkurrencës dhe zbulimin e abuzimit në treg si dhe autorizimin për ndërtimin e kapaciteteve të reja.

Ministria e Ekonomisë (ME) është përgjegjëse për të mbështetur dhe ndihmuar në përcaktimin e politikës së qeverisë për energjinë elektrike. Kjo bëhet përmes legjislacionit primar dhe legjislacionit sekondar. Përgjegjësi specifike e Qeverisë është përgatitja e strategjisë për sektorin dhe përcaktimi i objektivave që duhet të mbështesë ky Model.

Operimi fizik

- **Operatori i Sistemit të Transmisionit (KOSTT)** është i licencuar nga ZRRE dhe është përgjegjës për sigurimin e funksionimit efikas të sistemit, balancim të sistemit dhe rrjedhave ndërkufitare, por përveç humbjeve dhe çështjeve specifike të operimit të sistemit, nuk bën tregti me energji.


	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 13 prej 46</i>

- **Operatori i Tregut (gjithashtu KOSTT)** është i licencuar poashtu nga ZRRE-ja dhe është përgjegjës për mbajtjen e një sërë rregullash për treg që rregullojnë pjesëmarrjen në treg, përgjegjësinë e balancimit, çmimin e jobalancit dhe barazimit përfundimtar të jobalanceve – një treg balancues që reflekton koston i lehtëson këto detyra. OT nuk bën tregti me energji. OT është përgjegjëse për organizimin dhe funksionimin e tregut të energjisë elektrike, bazën e të dhënave matëse përfshirë grumbullimin e leximeve të njehsorëve dhe atribuimin e palëve tregtare përkatëse. OT aktualisht është gjithashtu OER.
- **Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS)** është i licencuar nga ZRRE për të menaxhuar shpërndarjen fizike të energjisë tek konsumatorët dhe gjithashtu është përgjegjës edhe për blerjen e humbjeve në shpërndarje.

Si OST ashtu edhe OSSH janë përgjegjës për kyçjet në rrjetet e tyre me tarifa të rregulluara dhe për mirëmbajtjen dhe zhvillimin e rrjeteve përkatëse.

Operimi i tregut

- **Operatori i Tregut** kryen këtë funksion në përputhje me obligimet e përcaktuara në Ligj, OT drejton procese nga fillimi në fund që përfshijnë regjistrimin e palëve dhe kontratave, barazimin përfundimtar të jobalanceve dhe faturimin në emër të të gjitha aktiviteteve të KOSTT-it.
- **Operatori i Bursës së Energjisë Elektrike.** Organizimi i tregut një ditë para dhe brenda ditës është përgjegjësi e OST-së dhe OT-së sipas Ligjit. Megjithatë, KOSTT ia ka bartur përgjegjësinë ALPEX-it për kryerjen e këtyre aktiviteteve:
 - Organizimi i **tregut një ditë para** që funksionon si një ankand përfundimtar me ALPEX si palë kontraktuale për të gjitha palët e tjera tregtare.
 - Organizimi i **tregut brenda ditës** me ALPEX si palë kontraktuale për të gjitha palët e tjera tregtare.
 - Organizimi i bashkimit të tregut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë duke përdorur kapacitetin 'rezervë' të njoftuar nga SEE CAO për të përcaktuar sasinë maksimale të energjisë që mund të transferohet ndërmjet zonave ofertuese (operimi i bashkimit të tregut shpjegohet më poshtë).
- **Operatori i Energjisë së Ripërtërishme (OER).** Aktualisht OT e ka këtë rol, i cili përfshin menaxhimin e Fondit të Energjisë së Ripërtërishme e në veçanti:
 - Duke vepruar si PPB për prodhuesit e energjisë së ripërtërishme të regjistruar në fond
 - Duke blerë të gjithë energjinë nga prodhuesit e energjisë së ripërtërishme përmes MBE-ve që specifikojnë çmimin që duhet paguar për energjinë e matur
 - Menaxhimi i jobalancve që i atribuohet secilit prodhues të energjisë të ripërtërishme
 - Alokimi i energjisë që do t'u shpërndahet furnizuesve dhe ngarkimi i tyre me koston mesatare të bërë nga Fondi për t'u paguar prodhuesve të energjisë së ripërtërishme sipas MBE-ve të tyre.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 14 prej 46</i>

- **SEE CAO.** Siç u përmend më lart, KOSTT është aksionar i SEE CAO duke e deleguar përgjegjësinë e tij të menaxhimit të kongjestionit për nxjerrjen në ankand të DTF-ve ndërkufitare tek SEE CAO, përgjegjësitë e të cilit përfshijnë:
 - Organizimin e ankandeve periodike të DTF-ve në çdo kufi të përfshirë, të cilat janë vënë në dispozicion nga OST-të; DTF-të mund të jenë për një vit të plotë ose një pjesë të një viti
 - Regjistrimin e tregtimit sekondar të DTF-ve ndërmjet atyre që janë kualifikuar për të mbajtur të drejta të tilla
 - Pranimin e nominimeve të rrjedhës së energjisë kundrejt DTF-ve të fituara
 - Zbatimin e kushteve sipas parimit shfrytëzo-ose-shit për çdo DTF ndaj të cilit nuk është bërë asnjë nominim për energjinë dhe:
 - Nëse bashkimi i tregut është në dispozicion në një kufi, duke u ofruar këto DTF PX-ve në secilën anë të kufirit; përndryshe
 - Organizimin e një ankandi ditor të DTF-ve për atë kufi
 - Pagesat për DTF-të dhe kompensimi për mbajtësit e të drejtave për DTF-të e marra sipas dispozitave "shfrytëzo-ose-shit", duke iu transferuar çdo fitim nga bashkimi i tregut ose ankandet e një dite para këtyre mbajtësve të të drejtave
 - Njoftimi i OST-ve për nominimet e energjisë për kufijtë përkatës.


Tregtimi

ZRRE licencon palët tregtare të cilët mund të jenë:

- **Prodhuesit** që kontraktjnë për të shitur energjinë deri në kohën e mbylljes së tregut, të cilët gjithashtu mund edhe të blejnë energji për të përmbushur zotimet e tyre kontraktuale. Prodhuesit duhet të jenë palë përgjegjëse për balancim. Prodhuesit dorëzojnë oferta për shitje dhe oferta për blerje në OT për të zvogëluar ose rritur prodhimin e tyre fizik dhe ofertat e tilla aktivizohen sipas neovjës nga OST për të balancuar sistemin në kohë reale.
- **Furnizuesit** blejnë dhe shesin energji sipas kontratave dypalëshe për liferim të energjisë tek konsumatorët final. Furnizuesit kanë të drejtë të tregtojnë dhe gjithashtu mund të importojnë dhe eksportojnë energji. Furnizuesit janë palë përgjegjëse për balancim.
- **Konsumatorët me shumicë** blejnë dhe shesin energji në emër të tyre ose shesin energji palëve të tjera tregtare, por nuk mund t'ua shesin energjinë konsumatorëve fundor. Konsumatorët me shumicë mund të jenë përgjegjës për jobalancin e tyre si dhe gjithashtu mund të importojnë dhe eksportojnë energji.

PX vepron si një palë kontraktuale tregtare për të gjitha tregtitë në bursën e energjisë.

Të gjithë të licencuarit për tregtim të energjisë elektrike mund të kenë kushte sipas licencës së tyre që të kenë kapacitet të transferimit ndërkufitar për eksport apo import të energjisë elektrike.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 15 prej 46</i>

2.2 Masat e mundshme për të lehtësuar konkurrencën

Qasja strategjike më e rëndësishme për Modelin e Tregut është lehtësimi i konkurrencës. Kjo është përgjegjësi parësore e Rregullatorit por edhe OT e ka këtë si objektiv. Në vijim, përshkruhet se si mund të zbatohet kjo. Përgjithësisht mund të ndërmerren hapat e mëposhtëm praktik si vijon:

- **Rritja e tregimit në ALPEX**

Konkurrenca mund të përmirësohet nëse ALPEX do të bëhej më likuid. Aktualisht pjesa më e madhe e tregtisë së energjisë bëhet përmes Marrëveshjes për furnizim me shumicë (BSA) ndërmjet KEK-ut dhe KEDS/KESCO-s. Edhe nëse BSA do të tregtohej përmes ALPEX, kushtet e marrëveshjes bazë do të kërkonin një kontratë financiare ndërmjet KEK-ut dhe KESCO-s (Kontratë për Diferencën - shih fjalorin) që nuk do të kontribuonte efektivisht në likuiditetin në PX.

Masat për përmirësimin e likuiditetit mund të përfshijnë:

- KOSTT në rolin e OST, mund të blejë humbjet e transmetimit përmes ALPEX;
- KEDS si OSSH gjithashtu mund të prokurojë humbjet e shpërndarjes përmes ALPEX edhe pse KEDS e ka të drejtën kontraktuale të prokurojë disa humbje nga KEK-u sipas BSA-së;
- Energjia elektrike e burimeve të ripërtëritshme mund të shitet e gjitha përmes ALPEX;


Strategjia e qeverisë është të heqë gradualisht BSA-në, duke filluar më së voni në 2025 dhe duke përfunduar deri në vitin 2031; kjo do të rrisë aftësinë e KEK-ut për të ofruar energji në ALPEX. Nuk ka detaje të masave që mund ta sjellin këtë. Një opsion që do të ndikonte drejtpërdrejt në likuiditetin e ALPEX mund të ishte:

- Prodhuesi dominues (KEK) të shesë një pjesë të prodhimit të tij përmes ALPEX; ose
- Furnizuesi dominues (KESCO) të blejë një pjesë të kërkesës së tij për energji elektrike përmes ALPEX.

Zbatimi i strategjisë së Qeverisë për largimin nga BSA është i panjohur kështu që nuk mund të përfshihet në këtë Model të Tregut.

- **Inkurajimi i investimeve për prodhuesin e ri**

- **Prokurim direkt.** Kosova ka një histori të pasuksesshme të prokurimit të kapaciteteve të reja prodhuese me një përjashtim të kufizuar të kapaciteteve të reja të ripërtëritshme. Kjo mbetet jashtë fushëveprimit të këtij dokumenti të Modelit të Tregut sepse kërkon që Qeveria të hartojë dhe të angazhohet me veprime të nevojshme specifike. Ky dokument përshkruan një model që duhet të lehtësojë investimet e reja, por nuk mund të përfshijë masa për prokurimin e drejtpërdrejtë. Një prokurim i tillë nuk është pjesë e strategjisë së Qeverisë për momentin.

	MODELI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 16 prej 46</i>

- **Detyrimet apo pagesat e kapacitetit.** Një tjetër mundësi janë pagesat për sigurimin e kapacitetit. Kjo nuk është pjesë e strategjisë apo e modelit aktual. Megjithatë, nëse qeveria zgjedh, mund të vendosë:
 - **Ankandet e kapaciteteve prodhuese.** Këto tani janë të zakonshme në Evropë. Të gjithë prodhuesit bëjnë oferta për pagesat MW mbi bazën se ato do të jenë të disponueshme në pikun e sistemit. Kështu synohet të mbulohen 'paratë e munguara' nga tregjet e energjisë që kërkohen për të siguruar që prodhuesi të qëndrojë në funksion. Ankandi zhvillohet çdo vit për katër vjet në vazhdim, sepse mund të ofrohen edhe kontrata shumëvjeçare për të mbështetur investime të reja. Mungesa e kapacitetit aktual do ta bënte të shtrenjtë zbatimin e kësaj.
 - **Detyrimet e kapacitetit.** Kjo është e ngjashme me ankandet e kapacitetit, me përjashtim të faktit që furnizuesve u është dhënë detyrimi të prokurojnë certifikatat e kapacitetit nga prodhuesit për të siguruar që kapaciteti është i disponueshëm. Ka të ngjarë të jetë po aq e shtrenjtë në situatën aktuale të mungesës së kapaciteteve.

3 Modeli i Synuar

Siç u tha më lart, Modeli i Synuar i BE-së është përpunuar përmes kodeve të rrjetit. Struktura e modelit dhe komponentët e tij kryesorë të tregut përcaktohen në





Figura 2.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 18 prej 46</i>





Figura 2: Modeli i Synuar i BE-së

Ndarja e tregjeve në korniza kohore është një tipar kyç i Modelit, i cili është i zakonshëm në Evropë dhe që ka elemente të përbashkët me Modelin tashmë të zbatueshëm në Kosovë. Elementet janë:

- **Tregjet e ardhshme (afatgjatë).** Ky është një treg i energjisë në pjesën më të madhe të Evropës, i cili është model i ndjekur në Kosovë i mbështetur nga kontratat dypalëshe. Detajet e zbatimit mund të gjenden në seksionin 4.1.1 (shih Tregjet e ardhshme). Shqipëria ka ndjekur modelin e favorizuar në vendet nordike ku vetëm kontratat financiare tregtohen në afatin kohor të ardhshëm; kontratat financiare janë KpD-të. Kjo nuk është pengesë për rritjen e integritit të tregut.

Në harkun kohor të tregjeve të ardhshme, OST nxjerr në ankand të drejtat e transmetimit për tregtimet ndërkufitare. KOSTT, së bashku me disa OST regjionale dhe të Komunitetit të Energjisë, e ka transferuar këtë obligim në një platformë regjionale ankandesh përmes anëtarësimit të tij në SEE CAO (përkthyer në Seksionin 2.1). Marrëveshjet për tregtimin ndërkufitar janë përkthyer më gjerësisht në seksionin 4.2.5.

Kosova ka prokuruar edhe shërbime ndihmëse për rezervë përmes kontratave afatgjate dhe vjetore. BE-ja po synon për balancimin e produkteve të tregtueshme përtej kufijve një ditë para,

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 19 prej 46</i>

megjithatë produktet jo standarde mund të prokurohen gjithashtu me kontrata afatgjata. Aranzhimet e Kosovës për këtë treg janë përshkruar në Seksionin 4.2.7.

- **Tregu një ditë para.** I rëndësishëm si qasje evropiane, sepse ky lloj tregu koncentrohet në likuiditet. Të gjitha tregjet evropiane bëhen fizike në këtë fazë. Qëllimi i këtij tregu është pikëprerja e lakoreve të urdhërporosive të një ditë para, i cili përshkruhet në seksionin 4.2.3. Ekziston trendi inovativ në Evropë i bashkimit të tregjeve fqinje; kjo shpjegohet në seksionin 4.2.4.

SEE CAO përcakton se sa të drejta transferimi nuk janë nominuar dhe ofron kapacitetin e transferimit të papërdorur në tregun e përbashkët.

- **Tregu brenda ditës.** Ky është gjithashtu treg fizik me harmonizim të vazhdueshëm të pikëprerjeve të urdhërporosive në platformën e tregtimit për të korrigjuar pozicionet.

Kapaciteti i transmetimit të papërdorur mund të alokohet në tregtimit ndërkufitare në këtë hark kohor edhe pse kjo shpesh do mund të jetë kapaciteti i rrjedhës së kundërt, i cili është virtual dhe jo fizik.

Aranzhimet e Kosovës për këtë treg janë përshkruar në Seksionin 4.1.1 (Tregjet brenda ditës). Marrëveshjet e bashkimit të tregut shpjegohen në seksionin 4.2.4.

- **Tregu balancues.** Ky është një treg në kohë reale edhe pse pranimet e ofertave për shitje dhe ofertave për blerje mund të bëhen nga OST përpara fillimit të ditës. Kjo përshkruhet më detajisht në Seksionin 4.1.1 (*Tregjet në kohë reale*).

Barazimi Përfundimtar i jobalancave. Nuk është pjesë e diagramit, por është proces që ndodh pas ditës kur lexohen njehsorët dhe për palët e tregut konstatohet se kanë liferuar më shumë ose më pak se sa kishin kontraktuar për të liferuar ose përndryshe konsumatorët e palëve të tjera kanë konsumuar më shumë ose më pak nga sa kishin kontraktuar palët për të konsumuar. OT do të llogarisë çmimin me të cilin OST ka shlyer jobalancet; ky çmim reflektues i koston është si nxitje për palët për të balancuar pozicionet e tyre të matura përmes parashikimit dhe kontraktimit aktiv të energjisë së kërkuar për ta injektuar ose marrë. Aranzhimet e Kosovës për llogaritjen e stimulit balancues janë përshkruar në seksionin 4.1.3.


4 Operimi i tregut

4.1 Parimet e operimit të tregut

Parimet që qëndrojnë prapa Modelit të Synuar të BE-së të zbatuar në Kosovë bazohen në tregje konkurruese që ofrojnë stimuj për palët e tregut për të vepruar në mënyrë efikase për interesin e tyre më të mirë, gjë që çon në çmime më të ulëta për konsumatorët. Nxitja kryesore për palët është të balancojnë pozicionet e tyre të matura kundrejt parashikimeve të tyre për ato pozicione; mënyra kryesore për ta arritur këtë është përmes kontraktimit.

4.1.1 Tregjet dhe kontratat

Ekzistojnë disa lloje kontratash në treg. Disa nga këto kontrata janë në formate të standardizuara dhe zakonisht bëhen me palët e ashtuquajtura qendrore. Kontratat e tjera të lidhura ndërmjet palëve tregtare janë në formën e rënë dakord me ato palë tregtare. Kontratat mund të jenë për sasinë e energjisë ose për kapacitet ose për shërbime të tjera. Kontratat mund të jenë gjithashtu për tregje të ndryshme - tregjet

	MODELI I TREGUT TË ENERGIJË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 20 prej 46</i>

për liferimin e energjisë elektrike të një cilësie standarde ashtu si kërkohet mund të jenë të llojllojshme dhe komplekse.

Siç tregohet në Figurën 2 më sipër, tregu i përgjithshëm mund të ndahet në korniza kohore të ndryshme dhe çdo kornizë kohore mund të ketë tregje për energjinë, kapacitetin ndërkufitar dhe për shërbimet ndihmëse. Tregjet shtesë si për sigurinë e furnizimit (kapaciteti prodhues) nuk janë pjesë e Modelit të synuar të BE-së dhe nuk zbatohen në Kosovë; tregu për promovimin e burimeve të ripërtëritshme, megjithëse nuk është pjesë strikte e këtij Modeli, kërkon që rregullat të përshtaten ashtu siç përshkruhet në seksionin 4.3 më poshtë.

Tregjet e ardhshme


Tregjet e ardhshme mund të jenë si në vijim:

- **Tregjet e energjisë.** Kontratat e energjisë në tregun e ardhshëm mund të kenë forma të llojllojshme me detaje specifike të përshkruara në kontrata. Tregu operon nga çdo kohë (duke përfshirë shumë vite përpara) deri në kohën e mbylljes së portës së ditës para. E vetmja kërkesë e përhershme e një kontrate të tillë është që të dyja palët duhet të bien dakord për të nominuar sasi të energjisë sipas kontratës tek Operatori i Tregut deri në kohën e mbylljes së portës; në këtë kohë njoftimi duhet të përfshijë sasinë e energjisë që do të dorëzohet në çdo periudë të barazimit përfundimtar të ditës në vijim, kush jep dhe kush merr energji - këto kontrata njihen si Kontrata për Njoftim (nominim), të cilat shpjegohen në seksionin 4.2.2.
- **Kapaciteti ndërkufitar.** Kjo menaxhohet nga SEE CAO (me përjashtim të kufirit me EMS të Serbisë, qasja në të cilën është ende në proces negocimi). Kjo shpjegohet në seksionin 4.2.5 below.
- **Shërbime ndihmëse.** Këto janë kontrata të lidhura ndërmjet OST-së, KOSTT-it dhe Ofruesve të Shërbimeve Balancuese (OSHB – kryesisht janë prodhuesit por edhe ofruesit nga ana e konsumatorëve dhe, në të ardhmen, operatorët e ruajtjes). Kjo shpjegohet më në detaje në seksionin 4.2.7.

Tregjet një ditë para

Këto janë tregje në orët para kohës së mbylljes së tregut një dite para dhe përfshijnë:

- **Bursa e energjisë.** Rregullat e tregtimit për tregun e energjisë PX përcaktohen nga ALPEX. Detajet e funksionimit janë dhënë në seksionin 4.2.3 below.
- **Kontratat ndërkufitare të energjisë dhe bashkimi i tregut.** Përpara ankandit të një dite para të PX, në një orar të përcaktuar nga SEE CAO, mbajtësit e DTF duhet të nominojnë rrjedhat e energjisë kundrejt DTF-ve që ata mbajnë. Çdo DTF e panominuar (jo e nominuar për rrjedhën e energjisë fizike) më pas konvertohet në FTR; këto FTR përdoren në bashkimin e tregut (shpjeguar në seksionin 4.2.5).
- **Tregu bilateral.** Këto janë në fakt kontrata energjetike të bëra në të njëjtën mënyrë si në tregun e ardhshëm. Kontratat duhet t'i propozohen OT-së deri në mbylljen e portës një ditë para.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 21 prej 46</i>

- **Ofertat për shitje dhe blerje.** Këto janë kontrata të bëra ndërmjet OSHB-ve dhe OST-së në të cilat OSHB-ja vendos një çmim për MWh me të cilin do të paguhet për të rritur furnizimin fizik të energjisë elektrike dhe një çmim që do të paguajë për të ulur furnizimin. Ofertat për blerje dhe shitje duhet të dorëzohen në OT deri në kohën e mbylljes së tregut. Kjo shpjegohet më tej në seksionin 0.

Tregjet brenda ditës


Këto janë tregje që funksionojnë ndërmjet mbylljes së portës një ditë para një orë para kohës reale dhe përfshijnë:

- **Tregun e organizuar brenda ditës.** Kjo organizohet nga ALPEX dhe u lejon palëve tregtare të blejnë dhe shesin energji pasi parashikimet ndryshojnë (për shembull, parashikimet e përditësuara të prodhimit të burimeve të ripërtëritshme); Rrjedhat ndërkufitare të energjisë mbështeten në masën që DTF-të mund të prokurohen – kjo varet nga kapaciteti i disponueshëm pas çdo periode të përdorur për bashkimin e tregut, megjithëse kapaciteti i rrjedhës së kundërt do të jetë gjithmonë i disponueshëm.
- **Ankandet brenda ditës DTF.** DTF-të që nuk përdoren në nominimet e një dite para nuk do të konvertohen gjithmonë në FTR nëse bashkimi i tregut nuk mbështetet përtej kufijve të caktuar. Në ato raste, KOSTT do të marrë DTF të papërdorura dhe do t'i nxjerrë në ankand për ditën D (duke paguar çdo të ardhur te mbajtësit origjinal të DTF); mbajtësit e rinj të të drejtave afatshkurtra do të mund të nominojnë kundër tyre në tregun brenda ditës.
- **Tregu bilateral (TB).** Këto janë në fakt kontrata energjetike të bëra në të njëjtën mënyrë si për tregun e ardhshëm. Kontratat duhet të nominohen tek OT para kohës së mbylljes së portës për çdo periode të barazimit përfundimtar.

Tregjet në kohë reale

Këto janë tregje që operojnë në kohë reale dhe nën kontrollin e OST-së. Ato përfshijnë:

- **Tregun balancues.** OST pranon oferta për shitje dhe oferta për blerje për të siguruar balancimin e sistemit. Balancimi është veprimi i iniciuar nga OST në përgjigje të një ndryshimi të parashikuar midis asaj që është nominuar për dërgim fizik dhe parashikimit të OST-së për kërkesën aktuale. Tregu balancues plotësohet me shërbimet ndihmëse që përdoren nga OST në përgjigje të një devijimi aktual në frekuencë. Kjo përshkruhet në seksionin 0 below.
- **Shfrytëzimin e shërbimit ndihmës.** OST përdor kontratat e shërbimeve ndihmëse të bëra me OSHB-të në përgjigje të ndryshimeve të vërejtura në shkëmbimet ndërkufitare ndaj atyre të skeduluara dhe në frekuencë. Kjo përshkruhet në seksionin 0 below.
- **Tregtimin e shërbimeve ndihmëse të BE-së.** BE-ja po promovon produkte të standardizuara që mund të tregtohen në platforma të dedikuara përtej kufijve, por nuk ka finalizuar se si mund të garantohet kapaciteti i transferimit për këtë. Kjo vlen si për shërbimet balancuese ashtu edhe për shërbimet ndihmëse. Këto të fundit, nëse përdoren shpesh arkëtohen në terma të energjisë së përdorur përmes tregut balancues.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 22 prej 46</i>

Kosova do të zhvillojë aftësinë për të tregtuar produkte të shërbimit ndihmës afatshkurtër pasi këto të jenë të disponueshme në rajon; afati kohor për këtë është i papërcaktuar.

Tregjet financiare

Këto kontrata të tregjeve financiare janë kryesisht jashtë rregullave. Tregjet financiare nuk përjashtohen nga rregullat, por nuk ka dispozita të qarta për t'i inkurajuar ato. Përjashtim bëjnë KpD-të që parashikohen si një opSION për mbështetjen e burimeve të ripërtëritshme; edhe këtu, barazimi përfundimtar i kontratave KpD është kryesisht jashtë objektivave të rregullave të tregut.

4.1.2 Balancimi i tregut

Çdo palë tregtare vepron si një Palë Përgjegjëse për Balancim (PPB) ose pjesë e Grupit Balancues të një PPB. Kjo do të thotë që PPB është përgjegjëse për të siguruar që të balancojë vëllimet e injektiveve të kontraktuara të energjisë në sistem me shumën e vëllimeve të energjisë së injektuar që matet ose për të balancuar vëllimet e energjisë që është kontraktuar për të marrë nga sistemi me shumën e vëllimeve të energjisë së matur të marrë nga sistemi.


Natyrisht, në kohën e mbylljes së tregut një ditë para (14:00 në ditën D-1) bilanci kontraktual është kundrejt një parashikimi të injektimit të matur ose marrjes së matur. Koha e mbylljes së tregut të një ditë para është kur të gjitha kontratat (qoftë të TB - shih seksionin 4.1.1 (të tregjeve të ardhshme) – ose PX – shih seksionin 4.2.3) duhet të njoftohet OT.

Palët kanë një mundësi për të rishikuar pozicionet e tyre në afatin kohor brenda ditës deri në kohën e mbylljes së portës, e cila është një orë para fillimit të liferimit në kohë reale, por kjo ende konsiderohet parashikim i injektimit ose marrjes së matur, sepse matja fizike nuk do të jetë e disponueshme për palët deri pas përfundimit të orës së tregtimit (e njohur si periudha e barazimit përfundimtar të jobalanceve).

Kjo do të thotë që në realitet pothuajse gjithmonë do të ketë një jobalanc të mbetur që do të duhet të korrigjohet në kohë reale. Kjo bëhet nga OST.

Ekzistojnë dy elementë për balancimin:

- **Tregu balancues**, në të cilin OST pranon oferta për shitje dhe/ose oferta për blerje për të korrigjuar devijimet neto nga parashikimi i tij i pozicionit balancues. OST kërkon këtu t'i afrohet sa më shumë që të jetë e mundur vlerave që priten të realizohen për orë midis injektiveve dhe marrjes. Megjithatë, balanca duhet të jetë në bazë momentale (sekondë për sekondë) për të siguruar që frekuenca e sistemit të mbetet shumë afër 50 Hz;
- **Shërbime ndihmëse** – kryesisht nëpërmjet shërbimeve të kontraktuara. Shërbimet ndihmëse mbulojnë dy faktorë në tregun e energjisë: devijime të vogla momentale dhe devijime më të mëdha të shkaktuara nga dështimet e parashikimit të OST (si dështimet e një parashikimi të prodhimit të burimeve të ripërtëritshme) ose rënia e prodhimit ose ngarkesës për shkak të problemeve teknike (qoftë të një gjeneratori ose të një linje). Llojet e ndryshme të shërbimeve ndihmëse dhe mënyra se si ato aktivizohen më në detaje jepen në seksionin 4.2.7.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 23 prej 46</i>

Mënyra se si funksionon tregu balancues jepet në vijim:

1. Në kohën e mbylljes së tregut një ditë para (14:00 në D-1), OSHB-të do të dorëzojnë ofertën dhe çmimet e tyre për ulje ose rritje të prodhimit.
2. Në kohën e mbylljes së tregut (një orë para kohës reale), prodhuesit (dhe ofertuesit nga ana e konsumit) do të dorëzojnë pozicionet e tyre përfundimtare të nominimit fizik për orën në vijim (këto pozicione nuk pritët që të ndryshojnë ndjeshëm pozicionet e tyre në nominimet fillestare fizike në kohën e mbylljes së tregut një ditë para).
3. OST-ja grumbullon ofertat për blerje në rend zbritës të çmimeve ndërsa ofertat për shitje në rendin rritës të çmimeve të kapaciteteve të disponueshme për të ulur ose rritur injektimet neto në sistem. Kjo tregohet në Figura 3.
4. OST pranon ofertat për shitje dhe/ose ofertat për blerje për të balancuar sistemin bazuar në parashikimin e tij të jobalancit të sistemit që rezultojnë nga parashikimi i kërkesës kundrejt nominimeve fizike përfundimtare të grumbulluara që OST-së i janë dorëzuar.





Figura 3: Operimi i tregut balancues

Çmimi mesatar i ponderuar i të gjitha ofertave për blerje të aktivizuara do të përdoret për të kalkuluar çmimin e jobalancit ku sistemi rezultojt të jetë mbikontraktuar (“ka tepriçë”) ashtu që KOSTT-it i është dashur të udhëzojë prodhuesit që të zvogëlojnë prodhimin përmes pranimit të ofertave për blerje; kur sistemi është i nënkontraktuar (“ka mungesë”), atëherë çmimi mesatar i ponderuar i të gjitha ofertave për shitje të aktivizuara do të përdoret për të vendosur çmimin e jobalancit për atë periudë të barazimit përfundimtar.

Ky mekanizëm përdoret edhe aty ku ka kufizime lokale në sistem. Kjo do të thotë që OST duhet të kufizojë në rritje prodhimin neto të një pike të mbingarkuar (aktivizimi i ofertës për blerje) dhe të kontraktojë për energji shtesë në rrjedhë të kundërt të pikës së mbingarkuar (aktivizimi i ofertës për shitje). Aktivizimet e

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 24 prej 46</i>

tilla shënjohe për të siguruar që ato të mos hyjnë në llogaritjen e çmimit të jobalancit. Në praktikë, një shënim i tillë do të jetë i rrallë në sistemin e Kosovës.

4.1.3 Stimujt për të balancuar

Në përputhje me Modelin e Synuar të BE-së, kostot mesatare të bëra nga KOSTT në balancimin e sistemit duke përdorur tregun balancues dhe shërbimet ndihmëse do të përfshihen në kalkulimin e çmimit të jobalancit. Siç përshkruhet në seksionin 0 above, kjo do të bazohet në aktivizimin e ofertave për blerje kur sistemi ka tepriçë ose përndryshe në aktivizimin e ofertave për shitje kur sistemi ka mungesë.


Në Figura 4, jepet një shembull i stimujve balancues për furnizuesit. Furnizuesit do të përpiqen të shmangin ekspozimin ndaj çmimit të lartë të blerjes së sistemit (ÇBS) dhe çmimit të ulët të shitjes së sistemit (ÇSHS) duke parashikuar se çfarë mund të arrijnë këto çmime. Ekspozimi ndaj ÇBS është nëse sistemi ka mungesë ose ndaj ÇSHS nëse sistemi ka tepriçë, por furnizuesit nuk do ta dinë se sa do të jetë çmimi në ndonjë periudë të barazimit përfundimtar. Pra, strategjia e tyre balancuese kundrejt parashikimit të tyre do të varet nga ajo se si ata i parashikojnë çmimet e jobalancit.



Figura 4: Stimujt balancues

Dinamika e tregut është si më poshtë:

- Parashikimet e furnizuesve mund të jenë ose shumë të larta ose shumë të ulëta në masë të barabartë (lakorja e shpërndarjes në diagram) kështu që gabimi i tyre i parashikimit mund të kontribuojë në gabimin e parashikimit të sistemit në cilindo drejtim, nëse kontraktajnë kundrejt parashikimit të tyre të zakonshëm.
- Gabimet në parashikimet e prodhuesve të burimeve të ripërtëritshme janë po ashtu simetrike kundrejt parashikimit të tyre.
- Prodhuesit termikë mund të kontrollojnë liferimin e tyre kështu që mund të kontraktajnë me saktësi dhe pa gabime, përveç nëse përballen me rënie të njësisë. Nëse kjo ndodh, atëherë ata do të jenë dukshëm në mungesë ndaj pozicionit të tyre të kontraktuar dhe ka pak gjasa që mund të bëjnë diçka për ta zbutur jobalancin e tyre.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 25 prej 46</i>

Ekziston një probabilitet normal që sistemi të jetë afërsisht në balanc, por me një mundësi që në kohë të paparashikuara të jetë shumë i shkurtër, duke çuar në një rritje të çmimit në tregun balancues. Prandaj, rreziku i çmimit është asimetrik.

4.2 Operimi i tregut

Siç u tha më lart, Modeli i Tregut të Kosovës bazohet në Modelin e Synuar të BE-së. Përshtatjet në model janë bërë në masën që tregjet aktualisht janë shumë jolikuide me mungesë të fleksibilitetit operacional brenda sistemit. Ka mungesë të konsiderueshme të kapacitetit të disponueshëm prodhues.

Përderisa rregullat e tregut janë hartuar për të krijuar një mjedis ku konkurrenca (si me shumicë ashtu edhe me pakicë) mund të zhvillohet, ato në vetvete nuk mund të rrisin likuiditetin e nevojshëm në tregje dhe as kapacitetin fizik të ri të nevojshëm për furnizim të sigurt dhe fleksibël. Rregullat mund vetëm të lehtësojnë likuiditetin, duke qenë plotësisht në përputhje me synimet e Udhëzuesve të BE-së që pjesërisht zbatohen drejtpërdrejt përmes rregullave të tregut.

Ky seksion shpjegon se si zbatohen kërkesat kryesore operationale dhe si do të funksionojnë elementë të tillë.

4.2.1 Afatet kohore operationale




Figura 5: Afatet kohore të funksionimit të tregut


	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 26 prej 46</i>

Figura 5 përcakton sekuencën e tregjeve siç përshkruhet në Kapitullin 3.

4.2.2 Nominimi kontraktual

Që sistemi të operojë siç duhet, OT-së duhet t'i jepet informacion i saktë rreth kontratave. Deri në kohën e mbylljes së tregut një ditë para, të gjitha palët tregtare duhet të ofrojnë:

- Nominimet fillestare fizike për çdo orë të ditës në vijim, në mënyrë që OST të mund të njoftohet me nivelin e duhur të prodhimit të çdo njësie gjeneruese në atë orë; dhe
- Nominimet fillestare kontraktuale për secilën palë tregtare duke detajuar se sa energji po blejnë (dhe nga kush) dhe sa po shesin (dhe kujt) për çdo periudë të barazimit përfundimtar të ditës së ardhshme.

Kjo bëhet në një plotësim të vetëm që duhet të përputhet gjithashtu me vëllimet e kontraktuara kundrejt prodhimit. Format i dorëzimit është në përputhje me standardet e ENTSO-E. Përfshin gjithashtu rrjedhat e energjisë të nominuara kundrejt DTF-ve të alokuara.


Çdo palë tregtare paraqet nominime kontraktuale në emër të saj të cilat nominime duhet të harmonizohen me informacionin e dhënë nga pala tjetër kontraktuale. Nëse nominimet nuk janë të harmonizuara atëherë vlera më e ulët do të aplikohet. Mirëpo, tregtimet e bëra përmes PX dorëzohen si nominime kontraktuale nga PX në emër të saj dhe konsiderohen si nominime edhe të palëve kontraktuale të saj.

Pas kohës së mbylljes së tregut një ditë para, pozicioni i rishikuar mund të paraqitet si nominim fizik dhe kontraktual për çdo orë të ditës D para kohës së mbylljes së tregut brenda ditor, e cila është një orë para fillimit të periudës së barazimit përfundimtar. Këto rinominime ka të ngjarë të ndodhin kryesisht pas çdo ankandi një ditë para të DTF-ve, siç përshkruhet në seksionin 4.2.5 below.

4.2.3 Operimi i bursës së energjisë

PX operon sipas rregullave të ALPEX-it:

- Shitësit paraqesin urdhërporositë shitëse duke formuar lakoren që përbëhet nga çiftet çmim-MW në rritje monotone për çdo orë ose për blloqe orësh; blerësit paraqesin urdhërporositë blerëse duke formuar lakoren që përbëhet nga çifte çmim-MW në rënie monotone.
- ALPEX më pas ekzekuton algoritmin përkatës që rendit të gjitha urdhërporositë në një lakore të përbashkët të shitjes dhe blerjes duke i përshtatur edhe urdhërporositë e veçanta dhe më komplekse.
- ALPEX më pas ekzekuton algoritmin që gjen pikëprerjen e lakores së shitjes dhe lakores së blerjes, duke përcaktuar kështu çmimin e tregut.
- Shitësit e suksesshëm në ankand paguhen me çmimin e tregut për të gjitha shitjet e tyre të pranuar dhe blerësit e suksesshëm paguajnë çmimin e tregut për të gjitha blerjet e tyre të pranuar. Çdo urdhërporosi shitëse dhe blerëse e suksesshme në PX formon një kontratë dypalëshe ndërmjet palës tregtare dhe ALPEX.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 27 prej 46</i>

- Më pas ALPEX i nominon të gjitha këto shitje te OT si nominime kontraktuale.

4.2.4 Bashkimi i tregut

Aktualisht pritet të bëhet bashkimi i tregut ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, por bashkimet me tregje e tjera rajonale do të përfshihen aty ku është e mundur.

Figura 6 jep një përshkrim të thjeshtuar se si funksionon bashkimi i tregut midis dy tregjeve. Duhet mbajtur mend se DTF-të ndërmjet tregjeve që nuk e kanë nominuar energjinë konvertohen përkohësisht në Opsione FTR (siç përmendet në seksionin 4.1.1 above).

Pasi nuk ka një proces përfundimtar për përcaktimin e kapaciteteve totale ndërkufitare ndërmjet Kosovës dhe Shqipërisë, KOSTT do të ndajë një pjesë të nevojshme të kapaciteteve të disponueshme ndërkufitare në tregun e organizuar për qëllimet e bashkimit të tregut.

Kjo pjesë e ndarë do t'i nënshtrohet rishikimit të rregullt dhe mund të ndryshohet pas një vlerësimi të paraqitur nga KOSTT dhe të miratuar nga ZRRE. ALPEX ka të drejtë të kërkojë që KOSTT të iniciojë vlerësimin për rishikimin e sasisë së ndarë dhe pas vlerësimit të KOSTT-it, ky rishikim më pas mund të dorëzohet për miratim në ZRRE.

Si funksionojnë opsionet FTR

Opsioni FTR është një formë e kapacitetit të transmetimit, ku mbajtësit të së drejtës i paguhet diferenca pozitive e çmimeve të tregjeve të bashkuara. Në shembullin në Figurën 6, çmimi fillestar i tregut në Tregun A është më i ulët se në Tregun B. Një tregtar ndërkufitar që ka 1 MW kapacitet të panominuar transmetimi nga Tregu A në Tregun B tani ka 1 MW opsione FTR dhe do të presë që të paguhet me diferencën e çmimeve midis çmimeve të tregut të dy tregjeve për atë 1 MW. Nëse tregtari ndërkufitar do të kishte 1 MW DTF rezervë (të konvertuar në opsionet FTR) në drejtimin nga Tregu B në Tregun A, ata nuk do të merrnin asgjë sepse çmimi në Tregun B është më i lartë se në Tregun A. Opsionet FTR skadojnë pas shlyerjes të ditës para dhe kthehen në DTF gati për ditën tjetër.

Si funksionon bashkimi i tregut

Në bashkimin e tregut, ku ka një diferencë çmimi midis tregjeve, çdo kapacitet i panominuar (Opsionet FTR) mund të përdoret; duke u alokuar në mënyrë progresive nga tregu me çmim të ulët në atë me çmim të lartë. Siç është paraqitur në Figura 6, kjo ndikon në rritjen e kërkesës dhe çmimit në tregun A, në të njëjtën kohë, injektimi i energjisë në Tregun B është rritur (energjinë ofrohet nga Tregu A), gjë që ul çmimin e tregut në Tregun B.

Procesi vazhdon derisa:

- nuk ka më të drejta të panominuara të transmetimit për t'u përdorur; ose
- është arritur kufiri i pjerrtësisë për rrjedhën ndërkufitare; ose
- çmimet janë barazuar në të dy tregjet.

Ndryshimi përfundimtar i çmimeve midis tregjeve është çmimi që do t'u paguhet të gjitha opsioneve FTR të mbajtura nga palët përkatëse. Edhe pse kjo mund të konsiderohet si një marrëveshje e keqe për

mbajtësit origjinal të DTF-ve, të cilët shpesh nuk do të marrin asgjë, duhet të mbahet mend se mos nominimin e rrjedhave të energjisë kundrejt DTF-ve të tyre, atëherë këto DTF konsiderohen tepriçë edhe ndaj kërkesave reale të tyre kështu janë të pavlera edhe për ta.




Figura 6: Bashkimi i tregut

4.2.5 Tregtimi ndërkufitar

Rregulla të ndryshme zbatohen në kufij të ndryshëm. Synimi është që të gjithë kufijtë përfundimisht të operohen ngjashëm. Aktualisht, OST-të në secilën anë të çdo kufiri duhet të bien dakord se sa kapacitet transmetimi është i disponueshëm në çdo drejtim. Ata e bëjnë këtë duke vlerësuar skenarët të ndryshëm të prodhimit dhe konsumit dhe sa duhet të rezervohet për rastet e paparashikuara duke përcaktuar kështu kapacitetin e disponueshëm për tregtim. Kjo mënyrë pritet që të zëvendësohet me një metodologji të bazuar në rrjedha fizike të energjisë që do të rrisë sasinë e tregtimeve ndërkufitare.


Në vijim duhet theksuar se jo të gjitha DTF-të do të shiten domosdoshmërisht në ndonjë ankand të vetëm. DTF-të e pashitura mund të ofrohen në një ankand të mëvonshëm afatshkurtër, por do të trajtohen në të njëjtën mënyrë si çdo DTF tjetër kundrejt të cilit nuk është marrë asnjë nominim.

Operimet e ndryshme janë si më poshtë:

Kufiri me Shqipërinë

Kjo do të funksionojë plotësisht në përputhje me Modelin e Synuar të BE-së. Hapat operacional janë:

1. Kapaciteti Transmetues në Disponim (KTD) do të dakordohet për çdo vit nga OST-të në të dyja anët e kufirit.
2. KTD i njoftohet SEE CAO i cili më pas organizon ankande për të alokuar këtë kapacitet si DTF në periudha kohore vjetore dhe mujore.
3. Pasi DTF-të të alokohen dhe paguhen, ato mund të tregtohen me tregtarë të tjerë ndërkufitar duke njoftuar SEE CAO – tregtimet mund të jenë afatshkurtra ose të përhershme, por përgjegjësia financiare e SEE CAO mbetet për mbajtësin fillestar të të drejtave.

	MODELI I TREGUT TË ENERGIJË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 29 prej 46</i>

4. Para organizimit të ankandit në D-1, tregtarët ndërkufitar me DTF nominojnë rrjedhat e energjisë kundrejt DTF-ve për OST-të (ose OT) të cilët njoftojnë SEE CAO për nominimet e konfirmuara.
5. SEE CAO përdorë dispozitën shfrytëzo ose shit duke konvertuar DTF-të kundrejt të cilave nuk është nominuar në Opsione FTR.
6. Opsionet FTR i vihen në dispozicion ALPEX në Shqipëri dhe në Kosovë për t'i përdorur ato të drejta në bashkimin e tregut në ankandin e tregut një ditë para të organizuar nga PX.
7. Opsionet e panominuara FTR pas bashkimit të tregut janë të disponueshme për tregtitë ndërkufitare në tregun brenda ditës.
8. Opsionet e mbetura FTR më pas vihen në dispozicion për balancimin afatshkurtër ndërkufitar dhe të shërbimeve ndihmëse.
9. Opsionet FTR kthehen te mbajtësit e DTF-ve të gatshme për tregtimet dhe nominimet e ditës së ardhshme.


Kufijtë me Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut

Këta kufij do të funksionojnë si më poshtë:

1. Njësoj si për kufirin me Shqipërinë.
2. Njësoj si për kufirin me Shqipërinë.
3. Njësoj si për kufirin me Shqipërinë.
4. Njësoj si për kufirin me Shqipërinë.
5. SEE CAO përdorë dispozitën shfrytëzo ose shit dhe heq përkohësisht DTF-të e tepërta.
6. SEE CAO kryen ankande një ditë para të DTF-ve të panominuara dhe ua alokon ato ofertuesve të suksesshëm si DTF ditore.
7. Mbajtësit e DTF-ve ditore nominojnë rrjedhat e energjisë kundrejt kapacitetit të regjistruar për ta.
8. DTF-të ditore kthehen te mbajtësit origjinal të DTF afatgjatë.

Kufiri me Serbinë

Aktualisht nuk ka asnjë tregtim ndërkufitar për këtë kufi. KOSTT ka shprehur interesim me EMS të Serbisë për të rënë dakord për rregullat për tregimin ndërkufitar. EMS nuk është anëtare e SEE CAO ndërsa KOSTT ka për qëllim që edhe për këtë kufi të përdorë procedurat e ngjashme si në SEE CAO në kuadër të marrëveshjes. Për KOSTT-in e rëndësishme është të përcaktohet KTD ashtu që të mund të alokohet kapaciteti dhe të fillon nominimi edhe për këtë kufi. Varësisht prej marrëveshjes së arritur me Serbinë do të realizohet alokimi për këtë kufi.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 30 prej 46</i>

4.2.6 Shkëmbimi i Paqëllimshëm

Në zonën sinkrone të ENTSO-E të Evropës Kontinentale, çdo OST është përgjegjës për balancimin e zonës së vet rregulluese. Duke pasur parasysh se balancimi bazohet në informatat e parashikimit, Shkëmbimi i Paqëllimshëm (ShP) është i pashmangshëm. Në përputhje me mandatin e KOSTT-it për zgjerimin e bashkëpunimit me zhvillimet pan-evropiane, Kosova merr pjesë në metodologjinë e re për trajtimin e ShP-së. Kjo përfshin kompensimin financiar për shkëmbimet e paqëllimshme.

Procesi është i miratuar nga të gjitha OST-të e Zonës Sinkrone dhe administruar nga Administratorët e Qendrave Koordinative.

Të ardhurat (ose shpenzimet) neto nga ShP përfshihen në llogarinë balancuese të OST-së dhe të ardhurat ose shpenzimet mbulohen nga palët përkatëse në llogari.


4.2.7 Shërbimet ndihmëse

Llojet e shërbimit ndihmës

Shërbimet ndihmëse sigurojnë ruajtjen e cilësisë së furnizimit me energji elektrike. Ka disa lloje, jo të gjitha mbulohen drejtpërdrejt nga Modeli i Tregut.

Shërbimet janë si më poshtë:

- **Shërbimet që mbulohen nga Modeli i Tregut dhe Rregullat e Tregut:**
 - **Rezerva stabilizuese e frekuencës (FCR).** Kjo rezervë mbulon devijimet e vogla momentale në frekuencë. Është një shërbim i udhëhequr nga rregullimi automatik i turbinës në njësitë e përshtatshme gjeneruese. Për shkak të vështirësisë së përcaktimit se a aktivizohet ky shërbim për vetë zonën rregulluese apo për korrigjim të shkëmbimeve të paqëllimshme, KOSTT nuk e prokuron drejtpërdrejt këtë shërbim, por e përfshin si pjesë e barazimit përfundimtar të ShP-së (shih seksionin 4.2.6 above). Aktivizimi i FCR mund të zgjasë deri në 30 sekonda.
 - **Rezerva e restaurimit të frekuencës (FRR).** Kjo rezervë mund të jetë automatike (aFRR) ose e aktivizuar manualisht (mFRR). FRR synon të kthejë devijimin brenda intervalit të synuar pas një devijimi jashtë brezit.
 - **Rezervë zëvendësuese (RR).** Sikurse me shumë sisteme, Kosova nuk prokuron në mënyrë eksplicite RR. Aktualisht, ai mbështetet në tregun balancues dhe ofruesit ndërkufitarë. RR përdoret për të liruar FRR që të jetë e disponueshme në rast të një devijimi të ri të frekuencës.
- **Shërbimet që nuk janë pjesë e Modelit të Tregut dhe Rregullave të Tregut:**
 - **Mbështetja për fuqi reaktive.** Në mënyrë që të sigurohet tensioni stabil, kërkohet nga njësi specifike që të sigurojnë mbështetje në rritje ose zvogëlim të tensionit. Shërbimi është specifik dhe varet nga vendndodhja dhe nuk është pjesë e Modelit të Tregut. Aktualisht, ofrohet nga disa pjesë të konsumit me pajisje kompensimi reaktive.
 - **Startimi nga zeroja (Black start).** KOSTT është i detyruar sipas Kodit të Rrjetit për të zhvilluar një plan rikthimi në rast të humbjes totale të energjisë në rrjet. Ky plan duhet të mbështetet në gjeneratorët që mund të startojnë pa mbështetje nga rrjeti. Aktualisht nuk ka kontrata

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 31 prej 46</i>

shërbimi ndihmëse të “Black Start” për shkak të mungesës së kapaciteteve për këtë lloj të shërbimit.

Kontraktimi i shërbimeve ndihmëse

KOSTT ka kontrata standarde për prokurimin e shërbimeve ndihmëse. Nëse ka mjaft OSHB të afta për të ofruar shërbimet e kërkuara, KOSTT do të iniciojë ankande vjetore për prokurim.

KOSTT ka mundësinë të kontraktojë në mënyrë bilaterale me ofruesit duke përdorur një kontratë të standardizuar. Me qenë se Shqipëria është brenda të njëjtit bllok kontrolli me Kosovën, kontrata e saj për FRR me OST-në e Shqipërisë është në harmoni me rregullat e ENTSO-E.

Një kontratë tipike e shërbimeve ndihmëse do të vendosë dy çmime:

- Një çmim disponueshmërie e paguar për MW e vënë në dispozicion në çdo orë – kjo mbulon koston oportune të mbajtjes së atij MW në dispozicion në vend që ta ofrojë atë në tregjet e ditës një ditë para ose brenda ditës.
- Një çmim aktivizimi e paguar për MWh të përdorur që mbulon kostot variable të prodhuesit ofrues të shërbimit nëse ai sinjalizohet të japë ose të merr energji.

Sistemet e baterisë për ruajtjen e energjisë

Kosova është duke u konsideruar nga Programi Kompakt Kosovar i Korporatës së Sfidës së Mijëvjeçarit të Shteteve të Bashkuara për grante për instalim të njësive SBRE, që do të ofrojnë shërbime FRR dhe shërbime të tjera duke përfshirë edhe të ashtuquajturin arbitrazhin e energjisë.

Kosova nuk ka rregullore specifike për pajisje ruajtëse, por, sipas Modelit të Tregut, ato do të trajtohen si gjeneratorë për qëllime të llogaritjes dhe tarifave të transmetimit.

Një pajisje ruajtëse e energjisë elektrike funksionon duke blerë energji në tregjet me shumicë kur çmimet janë të lira dhe duke e shitur atë përsëri – duke përfshirë edhe përmes kontratave të shërbimeve ndihmëse – kur çmimet janë më të larta.


Këto pajisje SBRE do të ofrojnë një pjesë të fleksibilitetit që i mungon sistemit aktual të energjisë elektrike të Kosovës.

4.3 Promovimi i burimeve të ripërtëritshme

Sipas legjislacionit në fuqi, KOSTT- në funksionin e OT i është caktuar detyra e krijimit të MBE-ve me prodhues të miratuar të energjisë së ripërtëritshme dhe operimit të një Fondi për Energjinë e Ripërtëritshme për blerjen e energjisë së tyre. OT do të kalkulon kostot e veta për këtë operacion dhe do t'ua shpërndan energjinë furnizuesve proporcionalisht (duke mbuluar një pjesë të kostove të saj) dhe pjesën tjetër do të ngarkon nëpërmjet një tarife për furnizuesit në proporcion me shitjet aktuale në periudha të tarifimit.

4.3.1 Administrimi i burimeve të ripërtëritshme

Investimet në burimet e ripërtëritshme bëhen përmes ankandëve dhe autorizimit. Ministria do të organizojë ankandet për prodhues të burimeve të ripërtëritshme dhe do të japë të drejtën për kontrata

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 32 prej 46</i>

me çmime të garantuara për periudha të caktuara kohore, ndërsa ZRRE do t'i licencojë të njëjtit, si dhe do të lëshon autorizimet për aplikuesit që nuk marrin pjesë në ankande. Kontratat e lidhura do të jenë me OER-në, që do të jetë një njësi e organizuar, që mund të funksionojë në kuadër KOSTT sh.a. OER do të veprojë si PPB për prodhuesit e kontraktuar.

4.3.2 Kontrata me prodhuesit e ripërtëritshëm

Legjislacioni lejon lloje të ndryshme të kontratave që do të jenë të gjitha me OER:

- **Kontratat e trashëguara.** Këto do të jenë për prodhuesit ekzistues të BRE me MBE-të ekzistuese. Kushtet e MBE-së do të mbeten të njëjta nëse nuk ka marrëveshje të ndërsjellë për të kthyer kontratën në një formë të re. Prodhuesit i paguhet një çmim i garantuar për energjinë e prodhuar dhe ngarkohet për jobalancet në bazë të një formule specifike. Prodhuesi mund të përfundoj kontratën dhe ta shesë energjinë e tij në tregjet me shumicë, por në këtë rast nuk do të shesë më energjinë me çmimin e garantuar.
- **Kontratat direkte.** Prodhuesit mund të kontraktojnë me një çmim të garantuar për kapacitetin e ri të instaluar nëse ekziston një dakordim me Qeverinë. Kontrata mund të jetë për të gjithë ose për një pjesë të prodhimit të prodhuesit – formula për llogaritjen e energjisë në këtë rast për OER-në do të përcaktohet në MBE. Prodhuesi do të jetë përgjegjës për tregtimin e të gjithë energjisë jashtë kontratës. Prodhuesit do të jenë përgjegjës për nominimin e energjisë për periudhë të barazimit përfundimtar për ditën në vijim dhe do të përballet me kosto specifike balancimi.
- **Kontratat e ankandëve.** Kjo ka të ngjarë të jetë mënyra e preferuar e kontraktimit me prodhuesit. Ofertat me çmimin më të ulët për konsumatorët do të fitojnë dhe kontrata do të ketë dy komponentë:
 - **Çmimin e tregut**– duke iu referuar çmimit të tregut një ditë para për të gjithë energjinë e nominuar nga prodhuesi.
 - **KpD**– energjia e matur do të paguhet në diferencën ndërmjet çmimit të kontratës dhe çmimit të tregut; nëse çmimi i kontratës është mbi çmimin e tregut, diferenca i paguhet prodhuesit, por nëse është nën çmimin e tregut, atëherë prodhuesit ia kthejnë diferencën OER.


Ankandet mund të jenë për të gjithë ose një pjesë të kapacitetit të centralit – formula për ndarjen e pjesës së energjisë që do t'i ofrohet OER-së do të përcaktohet në MBE.

Përveç kontratave të trashëguara, të gjitha kontratat mund të jenë në dy forma:

- **E tregtuar nga OER.** Energjia sipas kontratës i dorëzohet OER-së, e cila më pas e shet energjinë.
- **Vetë-tregtuar.** Vëllimi i energjisë i njoftohet OER-së si një nominim fizik, por nominimi kontraktual i bëhet një pale të tretë (e cila mund të jetë Bursa e Energjisë, por ka të ngjarë të jetë edhe një furnizues apo edhe një tregtar ndërkufitar).

4.3.3 Balancimi i prodhuesve të ripërtëritshëm

Ekzistojnë dy forma të stimulimit balancues:

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 33 prej 46</i>

- **Për kontratat e trashëguara.** Prodhuesi paguan 25% të çmimit të jobalancit për çdo energji të jobalancit në MWh nga pozicioni i përcaktuar në nominimin e tij fizik. Kjo paguhet pavarësisht nëse jobalancit është pozitiv apo negativ. OER është përgjegjës për çdo jobalanc tjetër.
- **Për kontratat e vetë-tregtuara.** Prodhuesi është përgjegjës për të gjitha jobalancet dhe OER nuk paguan (ose paguhet) asgjë në lidhje me këto jobalance.

4.3.4 Shitja e energjisë së ripërtëritshme

Për të gjithë energjinë e tregtuar nga OER (përfshirë kontratat e trashëguara) mënyra e shitjes do të përcaktohet nga mundësitë e OER sipas legjislacionit ose përvojën e gjertanishme.

Opsionet janë:

- **Alokimi tek Furnizuesit.** Energjia e blerë nga OER do t'u shpërndahet furnizuesve në përpjesëtim me pjesën e tyre të parashikuar të shitjeve për konsumatorët fundorë në një vit (me parashikimin e informuar nga aksionet në vitin paraprak, por të përshtatur për furnizuesit e ri ose për furnizuesit që largohen nga tregu). Kjo do të zbatohet nëse OER nuk mund ta shesë energjinë në ndonjë mënyrë tjetër.
- **Shitja përmes Bursës së Energjisë.** OER mund të ofrojë energjinë me çmim zero në Bursën e Energjisë dhe do të marrë çmimin e tregut e një dite para.
- **Shitja me kontratë dypalëshe.** Nëse OER dëshmon se mund të marrë një çmim mesatar afatgjatë më të mirë për energjinë e shitur përmes kontratave dypalëshe, atëherë, mund të shesë një pjesë ose të gjithë energjinë në këtë mënyrë. OER ngarkohet të marrë çmimin më të mirë të mundshëm për energjinë e ripërtëritshme që shet.

4.3.5 Mbulimi i kostove


OER është një funksion jo fitimprurës, që operon Fondin e Energjisë së Ripërtëritshme për të qenë neutral ndaj pagesave dhe do të krijojë një tarifë për energjinë e ripërtëritshme për të mbuluar çdo mungesë në mbulimin e kostove të veta përfshirë edhe kostot e arsyeshme të operimit, të cilat duhet të miratohen nga Rregullatori. Kostot kryesore do të jenë për blerjen e energjisë nga prodhuesit e BRE-ve sipas kontratës, kostot e jobalancit dhe kostot e KpD. Meqenëse taksa do të vendoset një vit para, do të ketë gjithashtu një element korrigjues për tepricat ose mungesat nga viti i kaluar.

Tarifa do t'u ngarkohet furnizuesve për konsumatorët fundor në përpjesëtim me pjesën e tyre të energjisë së matur në çdo periudhë të barazimit përfundimtar të jobalanceve.

5 Rregullat e tregut – Zbatimi i Modelit të Tregut

5.1 Hyrje

Kjo është një përmbledhje e shkurtër e rregullave të tregut. Ato zbatojnë Modelin e Synuar dhe janë pjesë përbërëse e modelit të tregut. Dokumenti i rregullave të tregut detajon një sërë procesesh dhe detyrimesh për palët. Si i tillë, dokumenti është krijuar si një formë e kontratës shumëpalëshe që pjesëmarrësit duhet ta nënshkruajnë përmes një Marrëveshjeje standarde të Aderimit. Ashtu si me kontratat e tjera, disa pjesë

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 34 prej 46</i>

të Rregullave i detyrojnë pjesëmarrësit edhe pasi të kenë përfunduar pjesëmarrjen e tyre, gjëra të tilla si detyrimi për të paguar borxhin.

Rregullat e tregut janë përgjegjësi e OT-së siç specifikohet në nenin 23, paragrafi 7 i Ligjit për Energjinë Elektrike (Ligji Nr. 05/L-085).

Dokumenti bazë i rregullave të tregut është i ndarë në katër pjesë me tituj:

1. Dispozitat e përgjithshme
2. Operimi i sistemit
3. Barazimi përfundimtar
4. Administrimi.

Këto janë përshkruar më poshtë.

5.2 Pjesa I: Dispozitat e përgjithshme

Kjo pjesë përcakton strukturën e ndërtimit të tregut:

1. Objektivat dhe fushëveprimi

Objektivat janë të specifikuar në licencën e OT dhe janë paraqitur në seksionin 1.4 above.

Fushëveprimi i rregullave është çdo gjë që palët duhet të bëjnë për të përmbushur objektivat dhe për të përfshirë gjithçka të detajuar në rregulla.

Seksioni 1 i rregullave të tregut përfshin gjithashtu konventat e përdorura dhe shumë definicione të përcaktuara të nevojshme për zbatimin e rregullave.

2. Palët dhe llogaritë


Palët dhe përgjegjësitë janë përshkruar në seksionin 2.1. Një palë mund të ketë më shumë se një funksion pjesëmarrjeje.

OT përcjellë palët tregtare përmes llogarive të regjistruara të tyre. Një llogari do të përmbajë vëllimin e energjisë që transferohet në ose jashtë asaj llogarie dhe implikimet financiare të atij transferimi të energjisë në terma të jobalancit neto dhe të ardhurave të tjera financiare ose kostove të shkaktuara.

Pala tregtare mund të ketë një llogari injektimi dhe/ose një llogari dalëse. OSSH do të ketë gjithashtu një llogari për regjistrimin e tregtisë për të mbuluar humbjet e rritit të shpërndarjes për të cilat është përgjegjëse. OST ka dy llogari: njëra është për shpenzime të tilla si humbjet e rritit të transmetimit për të cilat është përgjegjës financiarisht dhe tjetra është për kostot e balancimit, të cilat i mbulohen nga palët tregtare.

3. Aderimi dhe tërheqja

Ekziston një proces administrativ që palët të aderojnë dhe të zbatojnë rregullat e tregut që përfshin përcaktimin e funksioneve pjesëmarrëse të zbatueshme dhe regjistrimin e njësive fizike (njësitë gjeneruese, matësit e konsumatorëve fundor, etj.). OT nënshkruan marrëveshjen e

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 35 prej 46</i>

aderimit me palën aderuese në emër të të gjithë nënshkruesve të tjerë. Regjistrimet duhet të mbahen të përditësuara.

Ekzistojnë gjithashtu procese që palët tregtare të bëhen PPB ose t'i bashkohen një grupi balancues të udhëhequr nga një PPB tjetër. Proceset i lejojnë palëve që të largohen nga një PPB dhe të bëhen një PPB më vete ose të bashkohen me një grup tjetër balancues. Kjo është një kërkesë ligjore; një palë në çdo kohë duhet të jetë një PPB ose anëtare e një grupi balancues.

Palët mund të dalin vullnetarisht nga tregu ose mund të përjashtohen për shkelje. Arsyeja më e zakonshme e përjashtimit në shumicën e tregjeve është paaftësia paguese. Përjashtimi është një çështje madhore dhe prandaj kërkohen procese të detajuara për të siguruar që ai të jetë i drejtë dhe proporcional.

4. Komunikimet operative

Kjo është një kërkesë për palët për të instaluar pajisje të përshtatshme për të komunikuar me OT (kjo është e ndarë nga sistemet për komunikim me OST).

5. Kërkesat për matjet

Ky seksion mbulon:

- Krijimin e Agjentit të Administrimit të Matjeve (AAM) në kuadër të OT, i cili menaxhon një bazë të dhënash matëse të instalimeve të njehsorëve dhe leximeve të njehsorëve
- Definicionet, standardet dhe të dhëna të tjera të njehsorëve dhe regjistrimit të tyre në AAM
- Proceset për leximin e njehsorëve dhe dorëzimin në AAM.

6. Ndërrimi i furnizuesit

Ky seksion mbulon:

- Komunikimin e furnizuesit të vjetër dhe atij të ri për një ndërrim të suksesshëm të furnizuesit
- Regjistrimin e njehsorit të furnizuesi i ri
- Ndërrimi grupor i furnizuesit
- Më shumë se një furnizues me një njehsorë dhe marrëveshja për alokimin e matjeve.


7. Alokimi dhe tregtimi i kapacitetit ndërkufitar

Proceset janë përshkruar në seksionin 4.2.5. Ky seksion merret vetëm me alokimin e DTF-ve dhe jo me nominimet e tregtimeve ndërkufitare (Seksioni 10 i Rregullave të Tregut).

8. Garancioni Financiar

Ky është një element i rëndësishëm në ruajtjen e aftësisë paguese në tregun balancues të OST dhe OT. Qëllimi kryesor i garancionit financiar është të sigurojë që palët tregtare të mos detyrohen të paguajnë shtesë për shkak të mospërmbushjes së obligimit të ndonjë pale tjetër tregtare.

Ky seksion i rregullave të tregut mbështetet nga një dokument procedural i rregullave të tregut.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 36 prej 46</i>

Procedura përfshinë llogaritjen e nivelit minimal të garancionit financiar që një palë tregtare duhet të depozitojë në OT, si dhe në çfarë forme instrumentet e garancionit financiar (para të gatshme ose garancione financiare) mund të depozitohen në OT.

Ekzistojnë procese për monitorimin nëse niveli i garancionit financiar është i mjaftueshëm. Dështimi për të siguruar garancion financiar të mjaftueshëm është shkelje materiale e rregullave të tregut.

5.3 Pjesa II: Operimi i Sistemit

Kjo pjesë e rregullave është bërthama e proceseve për mënyrën se si kryhen dhe regjistrohen të gjitha transaksionet e tregut. Operimi i Sistemit mbulon si vijon:

9. Parashikimin e ditës para

Ky është një seksion i shkurtër që detajon se si OST do ta bëjë dhe publikojë parashikimin e konsumit për orë për ditën në vijim. Për shkak se OST ka qasje në burime të shumta informacioni nga tregu, si dhe duke përdorur burime të jashtme siç mund të jenë të dhënat e parashikimit të motit, parashikimi mund të pritët që të jetë mjaftueshëm i saktë dhe i disponueshëm. Duke e publikuar këtë për të gjitha palët tregtare, palët e reja nuk janë në disavantazh në krahasim me palët aktuale dominante dhe mund të ulin koston e tyre të kontraktimit të saktë.

10. Nominimet ndërkuftare

Proceset për nominimet ndërkuftare janë përshkruar në seksionin 4.2.5 above. Ky seksion i rregullave të tregut trajton edhe bashkimin e tregut (shih seksionin 4.2.4 above).


11. Nominimet dhe ofertat

Nominimet fizike dhe kontraktuale janë përshkruar në seksionin 4.2.2 above. Nominimet kontraktuale përmes një PX janë përcaktuar në seksionin 4.2.3 above. Rregullat mbulojnë si nominimet fillestare ashtu edhe nominimet brenda ditës.

Ky seksion përshkruan gjithashtu detajet e kërkesave për nominime fizike dhe nominime kontraktuale të harmonizuara dhe të paraqitura nga palët tregtare.

Në këtë seksion të rregullave të tregut janë edhe proceset për dorëzimin e ofertave për blerje dhe të ofertave për shitje. Kjo bëhet deri në kohën e mbylljes së tregut një ditë para dhe përfshin OSHB-në që dorëzon çmimin në EUR/MWh me të cilin do të ishte i gatshëm të rriste prodhimin nëse udhëzohej kështu nga OST dhe çmimin që do të ishte i gatshëm të paguante për të reduktuar prodhimin nëse udhëzohej kështu nga OST. OSHB nuk ka nevojë të rezervojë kapacitet për këtë dhe ofertat për shitje ose blerje mund të aktivizohen nga OST vetëm nëse OSHB ka kapacitet të disponueshëm në momentin kur bëhet aktivizimi.

Njësitë gjeneruese të BRE-ve duhet t'i dorëzojnë OER-it nominimet përkatëse fizike dhe kontraktuale. OER, duke vepruar si PPB për prodhuesit e BRE do të shesë energjinë e blerë ose nëpërmjet PX ose përmes kontratave dypalëshe (nëse kjo është e dobishme) dhe do të bëjë nominimet e duhura kontraktuale për këtë qëllim. Në afat të shkurtër, OER mund të detyrohet të

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 37 prej 46</i>


alokojë energjinë tek furnizuesit në përpjesëtim me konsumin vjetor të vlerësuar të konsumatorëve fundor të tyre.

Prodhuesit e ripërtëritshëm mund të bëjnë rinominime edhe pse ato që njihen si kontrata të trashëguara nuk mund të bëjnë rinominime më pak se tre orë përpara kohës së mbylljes së tregut.

12. Tregu balancues

Ky seksion trajton proceset e aktivizimit në kohë reale të ofertave për blerje dhe ofertave për shitje nga OST. Konteksti i tregut balancues është përmbledhur shkurtimisht në seksionin 4.1.1 (shih nën titullin Tregjet në kohë reale). Rregullat e tregut janë më të detajuara si më poshtë:

- Palët tregtare OSHB duhet të paraqesin parametra dinamikë të dispeçimit për çdo njësi gjeneruese, të cilat japin parametra të saktë për çdo njësi që është në gjendje të bëjë në lidhje me përgjigjen ndaj një instruksioni të dispeçimit (si për shembull me çfarë gradienti mund të rris ose zvogëlon prodhimin). OST nuk mund të udhëzojë një njësi të operojë përtej kufijve të saj.
- OST përndryshe ka diskrecionin për të ndryshuar prodhimin për ndonjë njësi balancuese duke aktivizuar ofertat për shitje ose blerje. OST do të përdorë këto udhëzime për të bërë balancimin fizik të sistemit me kosto më të ulët. Këto udhëzime nuk mund të përdorin kapacitetin që është rezervuar për të ofruar një shërbim ndihmës (udhëzimi për aktivizim të kapacitetit të kontraktuar për shërbimin ndihmës bëhet sipas kontratës së shërbimeve ndihmëse).
- Aktivizimi i ofertës për blerje, përveç rastit kur mbivendoset nga një udhëzim i mëvonshëm nga OST, do të çojë në blerjen efektive të energjisë së prodhuesit nga OST me çmimin e ofertës për blerje. Një aktivizim i ofertës për shitje (përsëri, nëse nuk mbivendoset udhëzimi) do ta ketë efektin e shitjes së energjisë nga prodhuesi për OST-në me çmimin e ofertës për shitje. OST do të paguhet nga një aktivizim i ofertës për blerje ose do të paguajë para për një aktivizim të ofertës për shitje përmes llogarisë balancuese. Duhet të theksohet se aktivizimet e ofertave për blerje dhe shitje mund të bëhen edhe nga ana e konsumit.
- Aktivizimi i ofertës për shitje dhe blerje normalisht do të përfshihet në llogaritjen e çmimit të jobalancit, por disa aktivizime mund të shënjohen dhe të përjashtohen nga llogaritja e çmimit të jobalancit. Kjo do të jetë për shkak se pranimi është bërë për të lehtësuar një kufizim transmetimi dhe jo për të adresuar një jobalanc të energjisë në sistem.
- Kur ka reduktim të liferimit për konsumatorët fundorë, mund të bëhet një aktivizim i imponueshëm nëse pala tregtare të kishte ofruar reduktimin. Kjo mund të ndodhë nëse nuk ka energji të mjaftueshme në dispozicion përmes ofertave të dorëzuara ose nëse ka ndodhur një kufizim transmetimi. Çmimi i një aktivizimi të imponueshëm të ofertës për shitje do të jetë çmim i lartë i rregulluar i krijuar për të kompensuar në mënyrë të arsyeshme konsumatorët fundor për ndërprerjen e furnizimit.

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 38 prej 46</i>

13. Shërbimet ndihmëse, humbjet dhe shkëmbimet e paqëllimshme

Kjo është një tërësi aktivitetesh të bashkuara nga çështja e detyrimit të OST-së për të prokuruar dhe menaxhuar këto shërbime.

OST duhet të prokurojë humbjet e transmetimit me kosto më të ulët. Kjo mund të përfshijë ankande të organizuara nga OST, kontrata dypalëshe duke përdorur një formë kontrate standarde ose mund të prokurohen përmes PX. Kontrata e humbjeve të transmetimit, kur përdoret, mund të përfshijë kushte shtesë të pagesës duke përfshirë tarifat e rezervimit si dhe pagesat për energjinë të cilat kosto duhet të llogariten. Kostoja e humbjeve nuk mbulohet drejtpërdrejt nga tregu, por është pjesë e tarifave të rregulluara të operatorit të sistemit.

Së fundi, ky seksion i rregullave të tregut merret me trajtimin e ShP, i cili përshkruhet në seksionin 4.2.6 above.

5.4 Pjesa III: Barazimi përfundimtar

Ky seksion përshkruan proceset e nevojshme për llogaritjen dhe pagesat për barazimin përfundimtar të jobalanceve si dhe për shërbimet e ndryshme të përdorura nga operatori i sistemit. Ai mbulon:

14. Aktivizimin e ofertave për blerje dhe shitje

Ky seksion përshkruan se si llogaritet vëllimi i energjisë së aktivizuar nga ofertat për shitje dhe blerje për një periudhë të barazimit përfundimtar të jobalancit dhe se si llogariten dhe zbatohen më pas pagesat që rezultojnë. Pagesat neto janë akumuluar në llogarinë balancuese të OST. Seksioni përshkruan gjithashtu procesin e shënjitimit të ofertave që përshkruhet në fund të seksionit 0 above më lartë; Ofertat për shitje dhe blerje të shenjuara përjashtohen nga llogaritja e çmimit të jobalancit.


15. Llogaritjen e çmimit të jobalancit

Në seksionin 0 above janë përcaktuar parimet e llogaritjes së çmimit të jobalancit. Ky seksion i rregullave të tregut përcakton proceset dhe algjibrën e llogaritjes duke përfshirë metodologjinë për përjashtimin nga llogaritja e ofertave për shitje dhe blerje të shënuara.

16. Llogaritjet e barazimit përfundimtar

Mënyra e llogaritjeve është dhënë në këtë seksion të rregullave të tregut. Kërkesa themelore për barazimin përfundimtar është që energjia e matur në çdo periudhë të barazimit përfundimtar të jobalanceve duhet të jetë e barabartë me energjinë e kontraktuar. Nxitja për të qenë i balancuar përshkruhet në seksionin 4.1.3 abovei cili gjithashtu përshkruan disa nga arsyet pse kjo nuk do të arrihet çdo herë. Seksioni 16 i rregullave të tregut përshkruan:

- Si përmblihen të dhënat për kontratat dhe njehsorët për të arritur pozicionin e balancit neto të një PPB;
- Si vlerësohen të dhënat matëse për pjesën më të madhe të konsumatorëve, sepse ata nuk kanë informacion të matur për secilën periudhë të barazimit përfundimtar të jobalancit
- Mënyra e llogaritjes së jobalancit të një PPB

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 39 prej 46</i>

- Mënyra e pagesave dhe jobalancit të prodhuesit BRE siç është përcaktuar në seksionin 4.3.3 above
- Si llogariten humbjet në transmetim dhe si vlerësohen humbjet në shpërndarje
- Pagesat pas korrigjimeve të leximeve të njehsorëve
- Si llogariten pagesat për joliferimin e energjisë sipas ofertave për shitje dhe blerje për të siguruar që prodhuesi (ose pjesëmarrësi nga ana e konsumit) nuk mund të përfitojë nga një joliferim i tillë
- Rregulla specifike në rastin gati të pamundur që PX nuk arrin të nominojë saktë kontratat (një PX duhet të jetë gjithmonë në balanc për të gjitha tregtimet që bën si ndërmjetës në bursën e vet).

17. Detyrimet


Roli kryesor i OT-së është të ngarkojë palët për jobalancet. Megjithatë, ai vepron si agjent i OST-së në administrimin e tarifave të transmetimit, të cilat janë tarifa të rregulluara e të përcaktuara nga ZRRE. Tarifat llogariten në nivele të ndryshme në varësi të faktit nëse përdoruesi i sistemit është prodhues, prodhues në shpërndarje ose furnizues. Jo të gjitha tarifat janë të zbatueshme dhe kështu, ndërkohë që rregullat e tregut ofrojnë metodologji për llogaritjen e tyre, disa nivele tarifash mund të trajtohen si zero. Seksioni mbulon mënyrën se si llogariten tarifat për secilën periudhë të barazimit përfundimtar të jobalancave në fushat e:

- **Detyrimi për Rrjetin e transmetimit**, që zbatohet bazuar në konsumin e çdo furnizuesi në kohën e pikut të konsumit dhe ka dispozitë për t'u zbatuar edhe për prodhuesit në prodhimin e tyre të pikut.
- **Detyrimi për operim të sistemit**, e cila është një tarifë për MWh (qoftë e energjisë së injektuar në sistemin e transmetimit ose e marrë prej tij).
- **Detyrimi për operim të tregut**, e cila është një tarifë për MWh (qoftë e energjisë së injektuar në sistemin e transmetimit ose e marrë prej tij).
- **Rialokimi i pagesave të balancimit**, që është krijuar për të siguruar që KOSTT të jetë neutral ndaj parasë së gatshme duke ngarkuar çdo mungesë në llogarinë balancuese të OST-së dhe duke kthyer çdo tepicë. Këto pagesa janë për çdo MWh të injektuar ose të tërhequr nga sistemi.

18. Faturimi dhe pagesat

Ky seksion i rregullave të tregut përcakton faturimin e OT në emër të tij dhe gjithashtu për OST dhe OER. Ai mbulon:

- Proceset duke përfshirë faturat preliminare (duke lejuar kështu që palët tregtare të vërtetojnë të dhënat e leximit të njehsorit)
- Faturat e përgjithshme mujore dhe ciklin e pagesës

	MODELI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 40 prej 46</i>

- Detajet e të dhënave në dokumentin e faturës dhe informacioni që duhet të jepet për çdo rresht
- Llojet e tarifave që faturohen
- Kontestimin e faturës.

5.5 Pjesa IV: Administrimi

19. Procedurat e rregullave të tregut

Këto procedura ofrojnë detaje përkatëse për proceset ose formularët e plotësimit kështu që edhe këto mund të konsiderohen pjesë e Rregullave të Tregut. Procedurat e rregullave të tregut zhvillohen nga OT dhe duhet të miratohen nga ZRRE.


20. Modifikimi i rregullave të tregut

Ky seksion përcakton proceset në të cilat Rregullat e Tregut mund të modifikohen. OT është përgjegjëse për rishikimin e rregullave dhe propozimin e përmirësimeve, por të gjitha palët e interesuara mund të propozojnë ndryshime. Procesi përfshin analizën dhe hetimin e ndryshimeve të propozuara dhe raportimin e këtyre gjetjeve, së bashku me ndryshimet e propozuara në ZRRE. Asnjë modifikim nuk mund të hyjë në fuqi derisa ZRRE-ja ta aprovon atë.

21. Dispozitat e përgjithshme

Ky seksion mbulon dispozita të ndryshme shtesë për funksionimin efektiv dhe të rregullt të Rregullave të Tregut. Nënseksionet mbulojnë:

- **Aderimin në Rregullat e Tregut**– një dokument publik i hapur për të gjithë
- **Njoftimet**– formularët e pranueshëm për njoftimet zyrtare për ose nga OT
- **Datën e hyrjes në fuqi**– kur ZRRE të ketë miratuar Rregullat
- **Forcën madhore**– pezullim i përkohshëm i disa detyrimeve për ngjarje të përcaktuara jashtë kontrollit të një pale
- **Kushtet emergjente**– trajtimin e pasojave financiare për një palë tregtare në rast se OST bën udhëzime jashtë kushteve të rregullave të tregut gjatë një emergjence të deklaruar të sistemit
- **Transferimi (cedimi)**- nuk lejohet; një palë tregtare nuk mund të heqë të drejtat dhe detyrimet e saj
- **Auditimin** – e operacioneve të përshkruara në rregullat e tregut
- **Konfidencialitetin**
- **Përgjegjësinë**
- **Valuten** - Euro
- **Juridiksionin** – ligjet dhe gjykatat e Kosovës
- **Zgjidhjen e kontesteve** – përdorimi i Rregullës në fuqi për Zgjidhjen e Ankesave dhe Kontesteve në Sektorin e Energjisë për dëshmi në gjykatat sipas nevojës.

	MODELI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 41 prej 46</i>

Dispozita kalimtare


Dispozitat ligjore që trajtojnë çështjet në lidhje me Operatorin e Ruajtjes, sistemet e ruajtjes apo Njësinë e Ruajtjes të OST dhe çështjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tyre të përcaktuara në këtë akt, nuk do të zbatohen përderisa të miratohen me Ligjin për Energjinë dhe Ligjin për Energjinë Elektrike nga Kuvendi i Republikës së Kosovës, dhe të njëjtat duhet të vendosen sipas ligjeve të aprovuara.

Shfuqizimi

Me hyrjen në fuqi të Modelit të Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës, sipas vendimit të ZRRE-së, shfuqizohet dokumenti paraprak “Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës”, i miratuar nga ZRRE në vitin 2013.


Dispozita përfundimtare

1. Procedurat për modifikimin ose ndryshimin e këtij akti do të jenë të njëjta si për miratimin e saj.
2. Ky akt publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës. Në rast mospërputhjes ndërmjet versioneve, do të mbizotëroj versioni në gjuhën Shqipe.
3. Ky akt hyn në fuqi pas aprovimit me vendim të Bordit të ZRRE.


	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 42 prej 46</i>

Shtojca: Fjalori


FjalorTermi	Shkurtesa	Përshkrimi
Agjencia për Bashkëpunim të Rregullatorëve të Energjisë	ACER	Organi rregullator i BE-së, ndër përgjegjësitë e tjera, vendos standardet për mbikëqyrjen e tregut
Bursa Shqiptare e Energjise Elektrike	ALPEX	Një kompani shqiptare në të cilën KOSTT ka aksione që ofron shkëmbime energjie në Kosovë dhe Shqipëri
Shërbimi ndihmës	SHN	Një shërbim i ofruar OST-së nga OSHB-të për të siguruar stabilitetin e funksionimit të sistemit, veçanërisht në ruajtjen e frekuencës brenda niveleve të sigurta
Kapaciteti i disponueshëm transmetues	KTD (ATC)	Kapaciteti i disponueshëm transmetues për tregtim në një interkonektor ndërkufitar
Pala Përgjegjëse për Balancim	PPB	Një palë që regjistrohet në emër të saj dhe/ose në emër të palëve të tjera tregtare
Ofruesi i Shërbimeve Balancuese	OSHB	Një palë që ofron shërbime energjetike për OST-në si oferta për blerje dhe oferta për shitje në tregun balancues ose shërbime ndihmëse
Sistemi i Baterisë për Ruajtjen e Energjisë	SBRE	Një pajisje për ruajtjen e energjisë elektrike që përdoret kryesisht për të ofruar shërbime ndihmëse
Kontrata për diferencë	KpD (CfD)	Një kontratë financiare që përdor një çmim fiks për shlyerjen financiare midis palëve që nëse çmimi i tregut (çmimi i referencës) është mbi çmimin fiks të rënë dakord, shitësi i paguan blerësit diferencën midis çmimit të tregut dhe çmimit fiks, dhe nëse çmimi i tregut është nën çmimin fiks, blerësi paguan diferencën tek shitësi
Koha e mbylljes së tregut një ditë para		Koha në ditën para kur të gjitha nominimet fillestare duhet të jenë dorëzuar në OT

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 43 prej 46</i>


Tregu një ditë para		Tregu i ankandit një ditë para për energjinë elektrike që operohet nga ALPEX
Operatori i Sistemit të Shpërndarjes	OSSH	Person fizik ose juridik përgjegjës për operimin, mirëmbajtjen dhe zhvillimin e sistemit të shpërndarjes
OST e Serbisë	EMS	Operatori i Sistemit Transmetues i Serbisë
Sekretariati i Komunitetit të Energjisë	ECS	Është institucion përgjegjës për mbështetjen e aktiviteteve të përditshme të Komunitetit të Energjisë dhe monitorimin e zbatimit të Traktatit të Komunitetit të Energjisë
Traktati i Komunitetit të Energjisë	TKE (ECT)	Një traktat që Kosova ka nënshkruar së bashku me vende të Ballkanit Perëndimor (të njohura edhe si Palë Kontraktuese) dhe BE-së për zbatimin nga Palët Kontraktuese të Direktivave të BE-së në sferën e energjisë; Gjeorgjia, Moldavia dhe Ukraina janë gjithashtu Palë Kontraktuese
Rrjeti Evropian i Operatorëve të Sistemit të Transmetimit për energjinë elektrike	ENTSO-E	Një organizim i OST-ve që vendos rregullat për funksionimin e qëndrueshëm të zonave sinkrone
Zyra e Rregullatorit për Energji	ZRRE	Rregullatori i pavarur i sektorit të energjisë në Kosovë
Bashkimi Evropian	BE (EU)	Është bashkim politik dhe ekonomik i shteteve anëtare në Evropë
Modeli i synuar i BE-së		Një projektim për tregjet e energjisë elektrike që përdoret në të gjithë BE-në, por që lejon disa variacione të projektimit
Rezerva stabilizuese e frekuencës	FCR	Një lloj shërbimi ndihmës siç përshkruhet në seksionin 4.2.7
Rezerva e restaurimit të frekuencës	FRR	Një lloj shërbimi ndihmës siç përshkruhet në seksionin 4.2.7

	MODELI I TREGUT TË ENERGISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 44 prej 46</i>

Të Drejtat e Transmetimit Financiar	FTR	Një formë e të drejtave të kapacitetit të ndërlidhësit siç përshkruhet në seksionin 4.2.4 above
Mbyllja e portës		Koha një orë para kohës reale kur duhet të jenë dorëzuar të gjitha nominimet përfundimtare
Tregu brenda ditës (Intraday market)		Një treg ku transaksionet kryhen për blerjen dhe shitjen e energjisë elektrike me detyrimin e livrimit fizik, që operohet nga ALPEX midis mbylljes së portës së ditës para dhe një orë para kohës reale për çdo periudhë të barazimit përfundimtar të jobalancit
Kompania Kosovare për Shpërndarjen e Energjisë Elektrike	KEDS	Kompania e Sistemit të Shpërndarjes së Energjisë Elektrike të Kosovës
Korporata Energjetike e Kosovës	KEK	Kompania kryesore prodhuese në pronësi publike në Kosovë
Kompania Kosovare për Furnizim me Energji	KESCO	Furnizuesi dominues i energjisë elektrike
Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës	MTEEK (KEMD)	Ky dokument
Bashkimi i tregut (Market coupling)		Një formë bashkëpunimi për reduktimin e diferencave të çmimeve ndërmjet tregjeve të energjisë elektrike siç shpjegohet në seksionin 4.2.4 above
Operatori i Tregut	OT (MO)	KOSTT në rolin e tij zbatues të balancimit dhe shlyerjes së energjisë elektrike
Megavat	MW	Njësi matëse e fuqisë
Megavatorë	MWh	Njësi matëse e energjisë

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 45 prej 46</i>

Agjenti i Administrimit të Matjeve	AAM (MAA)	Pala (pjesë e OT) që drejton Regjistrin e Njehsorëve dhe procesin e ndryshimit të furnizimit dhe të gjitha proceset që lidhen me informacionin e matjes.
Regjistri i njehsorëve		Baza e të dhënave të informacionit rreth njehsorit duke përfshirë vendndodhjen e njehsorit, detajet e aksesit dhe leximet e njehsorit
Ministria e Ekonomisë	ME	Ministria përgjegjëse, ndër të tjera, për industrinë e energjisë elektrike
Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut	KOSTT	OST dhe OT e Kosovës
Tregu bilateral	TB	Një treg kontratash dypalëshe ku kontratat e ardhshme bëhen midis palëve tregtare që mund të lehtësohen nga ndërmjetësit, por mund të rregullohen drejtpërdrejtë midis palëve
E drejta e transmetimit fizik	DTF	Kapaciteti ndërkufitar i blerë në një kufi nga një tregtar i interkoneksionit që lejon rrjedhjen e energjisë në një drejtim të caktuar
Bursa e energjisë	PX	Një treg i organizuar i energjisë elektrike që zhvillon ankande energjie një ditë para dhe brenda ditës përmes një platforme të tregtimit të energjisë
Marrëveshja e blerjes së energjisë elektrike	MBA (PPA)	Një kontratë për shitjen dhe blerjen e energjisë elektrike
Detyrimi i Shërbimit Publik	DSHP (PSO)	Një obligim ligjor që ZRRE-ja mund t'ua vendosë ndërmarrjeve specifike të energjisë elektrike për të mbështetur një përfitim publik
Rregullore për integritetin dhe transparencën e tregut të energjisë me shumicë	REMIT	Një rregullore e BE-së që rregullon mbikëqyrjen e tregut dhe abuzimin e tregut e transpozuar edhe në Kosovë

	MODELI I TREGUT TË ENERGJISË ELEKTRIKE TË KOSOVËS	PO-MO-002
	<i>ver. 3</i>	<i>faqe 46 prej 46</i>

Fondi i Energjisë së Ripërtërishme		Një fond ligjor që përdoret për mbështetjen e prodhuesve të BRE dhe mbledhjen e çdo kostoje të tepërt nga furnizuesit
Operator i Energjisë së Ripërtërishme	OER (REO)	Një subjekt që operon Fondin e Energjisë së ripërtërishme dhe kontraktin me të gjithë prodhuesit e mbështetur të BRE-ve, duke vepruar si PPB e tyre
Burimi i Energjisë së Ripërtërishme	BRE (RES)	Një burim i energjisë së ripërtërishme që përdoret për prodhim të energjisë
Rezerva e zëvendësimit	RR	Një lloj shërbimi ndihmës siç përshkruhet në seksionin 4.2.7
Zyra e Ankandit të Koordinuar e Evropës Juglindore	SEE CAO	Subjekti pan-rajonal që drejton ankandet për DTF-të
Çmimi i blerjes i sistemit	ÇBS	Çmimi i barazimit përfundimtar të jobalancit i llogaritur kur sistemi ka mungesë energjie
Çmimi i shitjes i sistemit	ÇSHS	Çmimi i barazimit përfundimtar i jobalancit i llogaritur kur sistemi ka tepëri energjie
Palë tregtare		Një palë e tregut që rregullon kush tregon energji elektrike në Kosovë
Operatori i Sistemit të Transmetimit	OST	Një operator i një zone rregulluese të sistemit të transmetimit, përgjegjës për menaxhimin e rrjedhave fizike të energjisë në atë sistem dhe për të kontribuar në funksionimin e qëndrueshëm të sistemit sinkron në të cilin është i lidhur sistemi i transmetimit
Konsumator me shumicë		Person fizik ose juridik që blen energji për qëllime të rishitjes
Shkëmbim i paqëllimshëm	ShP (UE)	Rrjedhat e paqëllimshme ndërkufitare